

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**31.05.2023  
Ora 12:35**

***RENDI I DITËS***

**"Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 79, subjekti ankues : Partia Social Demokrate".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,**  
**Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** PSD.
- **Të tjera:** KRIIK

**Z. I. Rusmalı:** Përvetësuar me autorizim nga...  
Përvetësuar me autorizim nga...  
Përvetësuar me autorizim nga...

**Z. Ilirjan Hoxha:** Avokat.

**Z. I. Rusmalı:** Faleminderit avokat. Prezent është trupa e KAS në fakt në përbërje të plotë për dy minuta vjen kolegu. (zoti Koli Bele). Sekretari i Përgjithshëm i KQZ zoti Merkaj me ekpin e tij dhe siç u prezantua avokati i subjektit ankues. Çështjet proceduriale i kemi mbyllur që në seancën paraprake. Kërkesa për trupën deklarimet, pa pajtueshmërie nuk ka. Kështu që e fillojmë duke ia dhënë fjalën avokatit për të parashtruar kërkesën e vet ankimore.

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:** Faleminderit i nderuar! Subjekti elektoral Partia Social Demokrate e Shqipërisë ka paraqitur përpala panelit tuaj si organ kompetent ankimin e vet në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 541 datë 20.05.2023. I cili ka miratuar ka vodosur për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kryetar të bashkisë dhe këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Në kërkesën tonë ankimore kemi referuar në bazën ligjore bazuar në nenin 124 , 126 dhe vijuaj dhe 160 pika 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Duke pretenduar se në tabelën përbledhëse të rezultatit nuk është pasqyruar rezultati i drejtë i votave dhe në tabelat e paraqitura nga grupet e numërimit, rezulton që në një numër të madh të QV nuk figurojnë as votat e komisionerëve të anëtarëve të KQV për shkak të faktit se subjekti jonë elektoral ka disponuar të drejtën e përfaqësimit në KQV me një anëtar të komisionit dhe përveç kësaj përveç informacionit të marrë nga përfaqësuesit tanë në KZAZ dhe informacionit që ata disponojnë në KZAZ është deformuar rezultati i votave të numëruara dhe shpërndarja e tyre tek subjektet elektorale pjesëmarrëse në zgjedhje sa i takon leximit dhe për pasojë edhe shpërndarjes së gabuar të votave në eventualitet të ngatërrimit të siglave të subjekteve PSD dhe PDS për shkak të ngashmërisë së tyre apo në rastin më të keq edhe veprimit të qëllimshëm të anëtarëve të GNV-ve përkatëse në këto KZAZ që kanë numëruar votat dhe i kanë shpërndarë votat për llogari të subjekteve elektorale. Sipas pretendimit të zyrës elektorale të subjektit tonë në qytetin e Vlorës të jetë ndryshuar apo më saktë numri i votave të vlefshme të shpërndara subjektit tonë, është më i vogël se numri faktit i tyre së paku në 26 QV ku përkatësisht na rezulton një mospërputhje midis votave të pasqyruara në procesverbale nga grupet e numërimit dhe votave të cilat shtabi jonë elektoral dhe

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

përfaqësuesit tanë në këtë bashki kanë konstatuar midis asaj që janë së pari dhe që është më e rëndësishme dhe më e dukshme mos ekzistanca dhe mos pasqyrimi në procesverbale së paku i votës së anëtarëve të KQV të cilët haptazi janë prezantuar si përfaqësues të Partisë Social Demokrate dhe kanë konstatuar që në kutitë e tyre nuk gjenden as vora e tyre. Pra, janë gjithsej 26 QV votat e të cilave janë shpërndarë dhe lexuar në mënyrë të gabuar sipas pretendimit tonë. Në 15 nga këto qendra nuk rezultojnë as votat e anëtarëve të KQV mund të ecim me hipotezën që diku njëri nga anëtarët ose një nga këto vota të ketë qenë një votë e pa vlefshme dhe të mos figurojë se votë e vlefshme po të jetë trajtuar si e tillë, nëse ka qenë e pa vlefshme por që të besojmë që në 15 QV të mos figurojë as vota e komisionerit tonë na bën të dyshojmë që kemi veprime që e kanë cënuar leximin e drejtë të votës dhe shpërndarjen e votave në subjektet elektorale përkatëse. Për këtë arsyesh që kemi paraqitur ankimin objekt i këtij shqyrtimi duke kërkuar rinumërimin e votave të këshillit bashkiak në 26 kutitë e mësipërme, të cilat i kemi listuar ndryshimin e rezultatit të miratuar nëpërmjet vendimit nr. 541 datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke pasqyruar rezultatin e rinumërimit të këtyre kutive në tabelën përbledhëse dhe duke vendosur dhe urdhëruar ndryshimin e kësaj tabele sipas rezultateve të rinumërimit. Në ankimin tonë kemi listuar QV për të cilat kërkojmë rinumërimin e votave argumentat e ngritura nga subjekti dhe nga përfaqësuesit tanë janë sikurse parashtrova.

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit avokat. Sekretari i Përgjithshëm ka gjë për të thënë lidhur me çështjen?

**Z. Y. Merkaj:** Jo nuk kam. Na rezultojnë të pa bazuara....

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. I. Rusmali:** Në rregull kolegët? Po zoti Çefa.

**Z. E. Çefa:** Doja të pyesja një farë llogaritje para prake e keni bërë , në qoftë se e prezumojmë të saktë pretendimin tuaj domethënë për të gjitha koëto votat e devijuara po i quajmë kështu. Në qoftë se kjo vërtetohet cili është rezultati që synoni apo që do keni?

**Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:** Referuar shpërndarjes së votave të vlefshme që rezulton të jetë miratuar nëpërmjet tabelës të cilën neve e kundërshtojmë, rezultojnë dhe sipas përllogaritjes së përfaqësuesve të subjektit tonë na rezulton na mungojnë së paku 141 vota. Dhe kjo shifër nëse do të ndryshonte duke iu referuar shpërndarjes së mandateve dhe hersëve të relatuar në bazë të dhënave të tabelës së deri tanishme na mohon të drejtën e një mandati. Pra, diskutohet për 40 vota një mandat i jonit i një këshilltari në Bashkinë e Vlorës. Pra, pikërisht për këtë arsy duke çmuar që ky devijim ose ky lexim i gabuar ose ky pasqyrim i gabuar i votave të vlefshme na e sjellë këtë efekt dhe jemi në situatën që pas llogaritjes minimale neve tentojmë dhe pretendojmë 141 të spostuara po themi pikërisht për këtë motiv e kemi paraqitur ankimin sepse nëse do ishim në situata të tjera kuptohet nuk do ta vinim në lëvizje gjithë infrastrukturën zgjedhore dhe panelin tuaj të nderuar.

**Z. E. Çefa:** Qartë faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Po zoti Braho?

**Z. L. Braho:** Unë kam një pyetje tjetër, keni pasur vëzhgues për çdo tavolinë numërimi?

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita CAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:** Po e kemi sqaruar edhe në ankimin që kemi paraqitur, ka ndodhur një situatë e tillë. Unë kam qenë edhe vet i angazhuar si anëtarë i KZAZ-së në një nga KZAZ-të e Tiranës. Kuptohet që KZAZ ka aktivitetin e vet që fillon sidomos në ditët e fundit para votimit dhe numërimit, një aktivitet që fillon non stop për katër ose pesë ditë rresht. Janë njfotuar fillimisht nga përfaqësuesit e KZAZ-ve janë njoftuar fillimisht përfaqësuesit tanë si vëzhgues sepse neve nuk kemi pasur të drejtën e anëtarit të numërimit, kemi pasur të drejtën të caktojmë vëzhgues në grupet e numërimit. Janë njoftuar fillimisht që do të përfundojë numërimi për kutitë e votave për kryetarin e bashkisë dhe pastaj do të fillojë numërimi për këshillin bashkiak. Janë njoftuar që do të fillonte numërimi në orën 14 të datës 15 Maj. Ndërkohë çka ndodhur ka përfunduar numërimi në orën 9 e 30 paradite, i kutive për votat e Kryetarit të Bashkisë, dhe të gjithë vëzhguesit tanë të cilët nuk kishin interes po themi për të vëzhguar numërimin e kryetarit, ishin njoftuar të paraqiteshin në orën 2 ndërkohë ka filluar në orën 10 numërimi i votave për këshilltare dhe nuk ka pasur prezencë.

**Z. L. Braho:** Këto QV për të cilat ju keni pretendime janë QV të cilat janë numëruar gjatë këtij harku kohor nga ora 10 e 30 deri në orën 14?

**Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:** Janë dy ZAZ më shumë se 1 ZAZ të cilat kemi pretendime dhe pretendohet që janë në këtë interval gjithsesi dhe janë specifikuar QV ku pretendohet që votat të janë ngatëruar votat e PSD ti kenë kaluar PDS ...

**Z. L. Braho:** Po filmimet i keni marrë në KQZ në lidhje me numërimin.

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:** Filmimet janë marrë po duke pasur parasysh edhe kohën e madhe të tyre duke pasur parasysh edhe problematikën që haset për ti vëzhguar edhe identifikuar të gjitha deri në detaje nuk kemi mundur të identifikojmë nëpërmjet filmimeve situata të kësaj natyre. Gjithsesi mendojmë se sa të vëzhgojmë të themi nga 13 -15 orë filmime ndërkokë që sot janë të dokumentuara edhe në kutitë e votimit ndarja e fletëve të votimit sipas subjekteve është e ndarë me n jë fjalë gjykojmë që thjeshtë nëse do ti identifikojmë në secilën prej këtyre kutive të votimit fletat e ndara për secilin subjekt është lehtësish e identifikueshme nëse jemi në situatën kur është bërë një gabim i tillë nga numërueshit është një gabim apo mbase një veprim i qëllimshëm nga ana e tyre . Ne nuk mund të pretendojmë për veprime të qëllimshme por si subjekt çmojmë që mund jemi në situatën e një gabimi ose një lajhitje të kryer nga numërueshit për shkak të ngashmërisë së siglave dhe faktit që kanë qenë njëra pas tjetrës në fletën e votimit dhe në tabelën përbledhëse qoftë PSD qoftë PDS.

**Z. I. Rusmali:** Pjetje të tjera? Neve në seancën paraprake iu kërkuam në mënyrë të shprehur që të sillni prova. Jo sot keni ardhur në të njëjtën situatë pa referuar asnje provë dhe kërkonin rinumërim. Ju besoj që jeni i vetëdijshëm që rinumërimi ka rrethana të caktuara kur bëhet. Në dijeninë tuaj ka pasur kontestime për vlerësimin e votave në këto QV për të cilat ju kërkonin rinumërim?

**Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:** Në momentin e numërimit së paku kur vëzhguesit tanë kanë qenë prezent, nuk ka pasur kontestim për shkak të faktit sepse janë vëzhguesit, kanë shënuar numrin e votave të tyre, dhe nuk është se kanë konstatuar se do të ndodhë transferimi i tyre nga njëri subjekt në tjetrin për shkak të ngatërrimit eventual të siglës së subjekteve. E dyta, edhe në qoftë se ka pasur

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

ndonjë kundërshtim po nuk jemi në këtë situatë dhe nuk mund ta pretendojmë sot aq më tepër kuptohet nëse do ta ngrimin një pretendim të tillë sikurse edhe të gjithë pretendimet e tjera edhe ky do të duhet të ishte një pretendim që do të duhej bazuar në prova . Në procesverbalet e mbajtura nga KZAZ-të nuk rezulton i pasqyruar një pretendim i tillë.

**Z. I. Rusmali:** Pjetje tjetër? Çfarë është kërkesa?

**Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:** Atëherë, përfunsimisht kërkojmë që të rinumërohen ose më saktë të verifikohen minimalisht në rastin më të keq, në kutitë e votave ato vota të shpërndara përkatësisht për subjektet PSD dhe PDS dhe nëse do të konstatohet që do të kemi një mospërputhje midis tyre, së paku kjo mospërputhje ose ky ngatërrim të pasqyrohet në tabelat përkatëse.


**Z. I. Rusmali:** Në rregull, ne duhet të mblidhem për të trajtuar kërkesën tuaj për marrjen në shqyrtim të këtyre kutive. Për 5 minuta do të japim vendimin për këtë kërkesë.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora 12:50**

**Z. I. Rusmali:** Atëherë riçelim seancën KAS pasi mori në shqyrtim kërkesën për marrjen e kutive e 26 kutive të votimit specifikuara në kërkesë dhe për rinumërimin dhe rivlerësimin e tyre vendosi, rrëzimin e kërkesës për shak se kërkesa është e pa mbështetur në ligj, arsyetimin e detajuar të këtij vendimi të ndërmjetëm ne do ta japim ashtu siç na e përcakton ligji, bashkë me vendimin përfundimtar. Por kërkesa në thelb nuk përcakton kushtet dhe kriteret e përcaktuara

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

nga neni 136 i Kodit Zgjedhor për rinumërimin ose rivlerësimin e votave të caktuara për këtë arsyе rrëzohet. Tani kalojmë tek pretendimet përfundimtare. Keni gjë për të thënë në fund fare?

***Av. I. Hoxha, përfaqësues i PSD-së:*** Nuk kemi!

**Z. I. Rusmali:** Nuk keni gjë për të thënë. Mirë, atëherë do të vazhdojmë me shpalljen e vendimit. Në përfundim të shqyrtimin edhe pasi konsultoi në tërësi çështjen KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore si të pa mbështetur në prova. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas afatit ligjor në Kolegin Zgjedhor, duke filluar nga data e shpalljes. Faleminderit e mbyllim këtu seancën.

**Vendimi nr. 170**

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



**31.05.2023  
Ora 13:00**

***RENDI I DITËS***

**"Për shqyrtimin e kérkesës ankimore nr.80, subjekti ankues: Koalicioni Bashkë Fitojmë"( Rrogozhinë).**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,**  
**Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Staff KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike: BF ( Z.I. Kaso, Z. F. Nuri , Av. V. Gumi) , PS ( Z. E. Salianji, Z. M. Legisi)**
- **Të tjera: KRIIK**

**Z. L. Braho:** Mirëdita të gjithëve çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kérkesës ankimore me ankues Koalicionin Bashkë Fitojmë. Me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit nr. 531 datë 18.05.2023 për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Rrogozhinë dhe miratimin e tabelës së re përbledhëse pas rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në të gjithë QV të zonës zgjedhore Bashkia Rrogozhinë. Kundërshtimin po ashtu të vendimit 531 datë 18.05.2023 dhe miratimin e tabelës së re përbledhëse duke hequr rezultatin zgjedhor të QV 2224/1 IEVP Rrogozhinë. Shpalljen fitues për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë zotin Shkëlqim Hamit Hoxha propozuar nga subjekti zgjedhor Bashkë Fitojmë. Në seancën paraprake të zhvilluar në KAS janë pranuar për tu paraqitur si palë të interesuara subjekti zgjedhor, kandidati për kryetar bashkie për Bashkinë Rrogozhinë i mbështetur nga Koalicioni "Bashkë Fitojmë" zoti

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

Shkëlqim Hoxha. Po ashtu është pranuar edhe kërkesa e Partisë Socialiste si subjekt zgjedhor për të qenë palë e interesuar në shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore. Sot të pranishëm jam përfaqësuesit e Koalicionit Bashkë Fitojmë ju lutem prezantohuni për efekt procesverbali.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së:** Në përfaqësim të subjektit ankues Koalicioni Bashkë Fitojmë Ivi Kaso dhe Franci Nuri sipas autorizimit të depozituar.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit! Po ashtu i pranishëm është edhe vet kandidati i mbështetur nga Koalcioni “Bashkë Fitojmë” zoti Shkëlqim Hoxha, në cilësinë e palës së interesuar. I pranishëm është edhe...

**Kandidati Shkëlqim Hoxha:** Avokat Viktor Gumi, i cili do të përfaqësohem.

**Z. L. Braho:** Për palën e interesuar zoti Gumi!

**Av. V. Gumi:** Po, për kandidatin Shkëlqim Hoxha, me autorizim në seancë.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit! Po ashtu të pranishëm janë edhe përfaqësuesit e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Eridian Salianji dhe Mariglen Legisi.

**Z. L. Braho:** Po faleminderit! I pranishëm është edhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së zoti Ylli Merkaj. Ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët në lidhje me trupën

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

e KAS apo kërkesa të tjera paraprake që mund të keni në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së:** Jo, nuk kemi.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Atëherë, vijojmë me pretendimet e ankimoren, subjektit zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë në lidhje me kërkesën ankimore, fjalë për ju!

**Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së:** Faleminderit të nderuar! Ashtu siç jeni vënë në dijeni edhe nëpërmjet kërkesës ankimore parashtrimet tona në masën më të madhe përveç disa detajimeve dhe specifikimeve që do ti shtjellojmë edhe gojarisht, janë në pjesën më të madhe të përmendura në kërkesën ankimore që ju ka investuar. Objekti i kërkesës tonë ankimore është rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për kryetar në këtë ZAZ në ZAZ nr.43. Gara për zonën zgjedhore Bashkinë Rrogozhinë si dhe nxjerrjen nga tabela e rezultatit të një QV, e cila që në momentin që është krijuar dhe deri në rezultatin që ka prodhuar është e vesuar për shkak se jo vetëm personat që kanë votuar në të, kanë votuar në kundërshtim flagrant me ligjin por edhe për shkak të pa rregullsive të tjera të cilat kanë ndodhur gjatë procesit në këtë qëndër. Të cilat gjithsësi vetëm sa kanë shtuar dozën e paligjshmërisë në këtë qëndër dhe nuk janë objekt në vetvete le të themi i ati shformimi të rezultatit por në asnje mënyrë nuk mundet që kjo qëndër, rezultatin që ka prodhuar duke qenë që nga momenti i prodhimit të listës së zgjedhësve për këtë qëndër edhe deri në momentin që është hartuar tabela përfundimtare për të është bërë diçka në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të cili i shtjellon më së miri çështjen e mundësisë për të votuar në qëndrat e posaçme në këto lloj zgjedhjesh. Pra, në zgjedhjet për kryetar bashkie të dënuarve të cilët vuajnë

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

dënimin e tyre në institucionin e vuatjes së dënimit në IEVP-në përkatëse. Në këtë rast në IEVP-në Rrogzhinë, shkurtimisht objekti për sa i përket kërkesës së parë të kërkesës ankimore lidhet me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 531 datë 18.05.2023 për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit për kandidatë për kryetar bashkie Rrogzhinë. Më anë të së cilës është miratuar rezultati si vijon kandidati zoti Edison Memollaj mbështetur nga Partia Socialiste ka fituar 5133 vota dhe kandidati zoti Shkëlqim Hoxha mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka fituar 5103 vota. Në përfundim të kësaj vendimmmarrje Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shpallur fitues kandidatin zotin Edison Memollaj me një diferencë nga ankimumesi vetëm prej 30 votash.

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. I. Kaso:** Komisioneri Shtetëror i zgjedhejve ka shpallur fitues kandidatin zotin Edison Memolla, me një diferencë nga ankimuesi prej vetëm 30 votash. Theksojmë se në kundërshtim me atë çka do të ishte normale për këtë zonë zgjedhore e cila ka vetëm një KZAZ, përsëri rezultati është miratuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shkak se vendimmarja e KZAZ-së përkatëse lidhur me hartimin e tabelës përbledhëse të rezultatit dhe miratimin e saj për shpalljen fitues të njërit nga kandidatët nuk ka mundur që të finalizohet për shkak se katër prej anëtarëve të KZAZ-së kanë qënë kundër kësaj vendimmarje për shkelje gjatë procesit, dhe në përfundim në procesin e daljes së rezultatit veçanërisht për shkelje që lidhen me nxjerrjen e rezultatit në Qendrën përkatëse që ka qënë Qendra siç e përmëndëm dhe do të ndalemi më poshtë, e Bashkisë Rrogozhinë, por kjo është arsyja që ka detyruar Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve që më pas ta miratojë këtë vendim ai vet. Brenda afatit 5 ditor të parashikuar sipas ligjit, kemi investuar organin tuaj lidhur me shkeljet që kanë ndoshur në rradhë të parë gjatë procesit të numërimit, të tabulimit të rezultatit në ketë zonë, në të cilën kujtojmë se diferenca midis dy kandidatëve është vetëm 30 vota dhe një e dhënë referuese është që fletët e pavlefshme në këtë zonë zgjedhore, në këtë votim pra, në votimin në tabelën përbledhëse për rezultatin e Kryetarit të Bashkisë, është 276 vota, pra më shumë se 9 herë më e madhe se diferenca e votave midis dy kandidatëve. Gjithashtu vëzhguesit tanë, për shkak se subjekti që ne përfaqësojmë dhe kandidati që ne kemi mbështetur në këtë proces, për shkak të vendimmarjes të organit tuaj dhe të Kolegjit Zgjedhor nuk kanë patur të drejtën që të kenë numëruesh në të gjitha tavolinat e numërimit, por të kenë një numëruesh, pra të propozojnë numërueshin e katërt vetëm në tavolinat me numër tek të numërimit duke lënë kështu gjysmat e tavolinave pa numëruesh të subjektit tonë në procesin e numërimit dhe rrjedhimisht dhe informacionin që kanë mbledhur në momentin e parë, pra në momentin e bërges së

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

ankimit, pasqyrimit të ankimit përpara organit tuaj, kryesisht informacionin e kam marr nga vëzhguesit dhe nga personat që kanë qënë prezent atje gjatë procesit të numërimit, janë vërejtur një sërë parregullsish në procesin e tabulimit të këtij rezultati të cilat na kanë shtyrë që të kërkojmë që në momentin e parë një proces verifikimi të votave të pavlefshme, por jo vetëm votave të pavlefshme por edhe të mënyrës sesi janë vlerësuar si të vlefshme në një pjesë të Qendrave të Votimit në këtë zonë zgjedhore, duke konsideruar që procesi ka qënë i mangët dhe ka qënë një proces jo në përputhje me dispozitat e urdhëruar sipas Kodit Zgjedhor përsa i përket procesit të vlerësimit të votave duke konsideruar vota të vlefshme për njërin nga kandidatët dhe veçanërisht për kandidatin që është shpallur fitues, vota të cilat qartësisht ishin të pavlefshme, ose janë pavlerësuar pa arsyen ligjore vota të vlefshme për kandidatin tonë duke bërë kështu të mundur një deformim dhe një shformim të rezultatit i cili sipas mënyrës që është miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, shpall fitues kandidatin e Partisë Socialiste me vetëm 30 vota. Për këtë arsyen jemi drejtuar sikundër e do dhe praktika e mirë e proceseve ankimore të kësaj natyre, i jemi drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke i kërkuar që fillimisht të na vëj në dispozicion pamjet filmike të cilat i kemi administruar dhe i kemi kqyrur dhe nga të cilat na kanë rezultuar një sërë parregullsish të cilat i kemi detajuar në një tabelë të mëposhtme, të cilën unë po ua lexoj dhe do ju a vëmë dhe në disopzicion së bashku me disa pamje filmike që kemi mundur të ekstakulojmë nga pikëpamja vizuale në bazë edhe, le të themi, standartit që është ndjekur nga KAS-i në këto zgjedhje, në një çështje analoge jo më larg se dita e djeshme për aq sa kemi mundur të nxjerrim dje dhe sot nga pamjet filmike. Konkretisht për shembull, në Qendrën e Votimit, dhe këto janë detajimi të cilat nuk ndodhen në kërkesën ankimore pase vetëm përpara tre ditësh na u vunë në dispozicion, le të themi, pamjet filmike të cilat janë vizionuar nga ana jonë përgjatë këtyre ditëve.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

Konkretisht në Qendrën e Votimit 22 28/1, në procesverbal rezulton që kandidati Edison Memolla ka 150 vota ndërsa kandidati Shkëlqim Hoxha 92 vota, ndërkohë që nga procesi i këqyrjes së pamjeve filmike dhe rinumërimi që ne kemi bërë të kësaj praktike, rezulton që kandidati Edison Memolla ka 148 vota ndërkohë që kandidati Shkëlqim Hoxha ka 92 vota, pra 2 vota janë shtuar qartësisht kandidatit Edison Memolla. Në Qendrën e Votimit 21 54/1, kandidatit Edison Memolla i cili rezulton në procesverbal 82 vota, i është shtuar një votë në raport me atë çka ishte këqyrja e pamjeve filmike në të cilën ky kandidat kishte 81 vota të vlefshme. Në Qendrën e Votimit 22 26, në procesverbal ka 99 vota kandidati i cili është shpallur fitues, përkundër 99 votave që ka edhe kandidati Shkëlqim Hoxha, ndërkohë që në procesin e rinumërimit rezultojnë vetën 98 vota të vlefshme për këtë kandidat, 99 vota të vlefshme sikundër dhe është tabuluar për këtë Qendër edhe për kandidatin Shkëlqim Hoxha. Në Qendrën e Votimit 22 29 në procesverbal rezulton Edison Memolla 22 vota, Shkëlqim Hoxha 117 vota, ndërkohë që nga procesi i këqyrjes pra i pamjeve filmike, rezulton se kandidati Memolla ka 122 vota ndërkohë që kandidati Shkëlqim Hoxha ka 118 vota pra 1 votë më shumë e cila nuk i është tabuluar në tabelën përfundimtare të rezultateve në këtë Qendër Votimi. Në të njëjtën mënyrë vazhdojmë me Qendrën 21 52, ku në procesverbal kandidatit Edison Memolla i rezultojnë 72 vota ndërkohë që në proces tq këqyrjs së pamjeve filmike rezultojnë 71 vota të vlefshme. Në Qendrën e votimit 21 97/1, në procesverbal kandidatit Edison Memolla ka 87 vota nga procesi i rinumërimit shohim që kandidatit Shkëlqim Hoxha në këtë Qendër Votimi një votë e tij e vlefshme është deklaruar e pavlefshme prandaj nga këqyrja e pamjeve filmike kanë rezultuar 91 vota të vlefshme, por janë tabuluar vëtëm 90 vota. Të njëjtën gjë kemi vërejtur edhe në Qendrën e Votimit 22 27/1, ku përsëri një votë për kandidatin Shkëlqim Hoxha është deklaruar e pavlefshme në mënyrë të kundërligjshme pasi vota ishte qartësisht votë e vlefshme,

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

është tabular si votë e pavlefshme dhe rezultati përfundimtar në këtë Qendër Votimi duhet të ishte 117 vota për kandidatin Shkëlqim Hoxha, dhe jo 116 vota, sikundër është tabular në tabelën përfundimtare të rezultatit në këtë Qendër. Kujtojmë që vetëm nga sa kemi mundur të shohim ne nga pamjet filmike, në kohën e shkurtër që kemi patur në dispozicion dhe le të themi kemi bërë prezent edhe nëpërmjet pamjeve filmike, do ja depozitojmë dhe KAS-it dhe nëpërmjet një USB-je atë çka kemi mundur të ekstrakulojmë, vetëm nga një këqyrje e parë pra siç e thamë, kandidatit Edison Memolla i janë zbuluar të paktën pesë vota më shumë nga sa ishin në realitet, ndërkohë që kandidatit Shkëlqim Hoxha nuk i janë tabular të paktën tre vota të cilat qartësisht ishin të vlefshme dhe janë konsideruar si të pavlefshme. Kjo ka qënë arsyja të cilën ne kemi kërkuar që në kuadër të një proçesi hetimor të drejtë dhe të saktë, përsa i përket këaj zone zgjedhore është i nevojshëm rinumërimi dhe rivlerësimi i të gjithë fletëve të votimit, si të vlefshme dhe të pavlefshme të të gjitha Qendrave të Votimit në këtë zonë zgjedhore se vetëm kështu do të kemi garancinë që rezultati përfundimtar do të rezultojë nga ky proces, do të tregojë të vërtetën e procesit që duhet të kishte rezultuar që në momentin e numërimit fillestar në KZAZ, por që përfat të keq nuk ka ndodhur. Kjo ishte shkurtimisht përbledhja e shkeljeve që kanë ndodhur në procesin vetëm të numërimit dhe të tabulimit të rezultatit, por siç e përmendëm më lart, një pjesë e mirë e shkeljeve dhe masa kryesore e shkeljes që ka ndodhur në këtë zonë zgjedhore, lidhet me çfarë ka ndodhur në qendrën përatëse të JHP-së, së Bashkisë Rrogozhinë, Qendra Votimit përkatesisht 22 24/1. Kujtojmë që kjo Qendër në procesin e numërimit ishte Qendra e fundit e cila është hapur dhe është numëruar, dhe në momentin kur është hapur dhe numëruar kjo Qendër kandidati Shkëlqim Hoxha, kandidati i mbështetur nga ana e subjektit tonë zgjedhor, rezultonte fitues me një diferençë prej 57 votash mbi kandidatin Edison Memolla dhe është vetëm rezultati i kësaj Qendre i cili ka përbysur rezultatin duke

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

krijuar diferencën prej 30 votash. Në ndryshim nga praktika të tjera të mëparëshme të cilat i kemi referuar këtu përpara jush lidhur me Qendrat që krijojnë në institucionet e posaçme të vuajtjes së dënimit, në këtë Qendër le të themi, ka patur një listë përfundimtare zgjedhësisht, në momentin që në datën 4 prill është miratuar ose ka dalë lista përfundimtare e zgjedhësve. Pra është një Qendër e cila ka lindur si e tillë, si Qendër e Posaçme por jo detyrimisht do të thotë që është krijuar si e tillë në mënyrë të ligjshme, në mënyrë të drejtë, duke zbatuar rigorozisht dispozitat ligjore, pasi për fat të keq vlerësojmë se në të njëjtën mënyrë si në raste të tjera është ngritur në kundërshtim me ligjin një Qendër e Posaçme në këtë institucion të vuajtjes së dënimit, ku i është dhënë mundësia personave të cilët nuk kanë të drejtë të votojnë, në bazë të dispozitave urdhëruuese të ligjit, personave të cilët nuk e kanë vendbanimin në këtë zonë zgjedhore që të votojnë në kundërshtim me ligjin dhe të krijojnë rezultat zgjedhor. Ne kemi bërë përçapjet tona përsa i përket kërkimit të informacionit në institucionet përkatëse të cilët kanë administruar procesin e mbajtjes së të dënuarëve dhe disponojnë edhe të dhënat e tyre përsa i përket Qendrave, në rastin konkret të Bashkisë Rrogozhinë dhe rezulton nëpërmjet përgjigjes që na ka ardhur se nga të gjithë shtetasit të cilët vuajnë dënimin në këtë Qendër dhe që ju është lejuar pjesës më të madhe të tyre nëpërmjet paraqitjes së tyre në listën përfundimtare të zgjedhësve përsa i përket kësaj Qendre, por të paktën edhe tre shtetasëve të tjetë nëpërmjet vendimeve të gjykatës, ju kanë dhënë të drejtën që të votojnë në këtë Qendër, prej gjithë shtetasve që kanë votuar ose më saktë që mbaheshin por dhe që u është garantuar e drejtë e votës në këtë Qendër Votimi, kanë qënë shtetas të cilët vendbanimin e tyre e kishin Bashkia Rrogozhinë, pra sipas mënyrës që legislatori ka shkruar ligjin, në rastin konkret Kodin civil, ligjin për gjendjen civile dhe në bazë të interpretimit që gjykata Kushtetuese i ka bërë me vendimin numër 40 të vitit 2007, vetëm ato dy shtetas kishin të drejtë që të votonin, por do desha më shumë që

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

lidhur me shtjellimin e kësaj parregullsie dhe problematikave që mbart kjo Qendër t'ja jepja fjalën kolegut, përfaqësues të kandidatit Shkëlqim Hoxha, për ta detauar më shumë qëndrimin tonë lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Po faleminderit zoti Kaso, fjala për zotin Gume.

**Z. V. Gumi:** faleminderit të nderuar anëtarë të KAS-it, si fillim unë doja vetëm të citoja një shkresë zyrtare që është bërë nga institucioni i egzekutimit të vendimeve penale Rrogozhinë, me numër 13 91 protokolli të datës 21.03.2023 dhe që i është drejtuar Bashkisë Rrogozhinë, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjëndjes Civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në këtë shkresë të cituara drejtori i këtij institucioni e mbyll me këto fjalë, ‘nga ana jonë nga lista e plotë e të dënuarëve që vuajnë dënimin në institucionin tonë, janë hequr me përjashtimet e ligjit 138/2015, të dënuarit përkatës, dhe kanë mbetur 118 të dënuar, të cilët mbeten për tu vlerësuar nga ana juaj nëse do të përfshihen ose jo në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 duke marr parasysh faktin që janë zgjedhje për Kryetar Bashkie.’ Një drejtor i një institucioni tërheq vëmendjen e të gjithë shtetit dhe i thotë, a duhet të përfshihen këta të burgosur në Qendrën e Votimit për organet e pushtetit vendor. Situata bëhet akoma më paradoksale, pse, sepse Qendra e Votimit të burgut Rrogozhinës u la e fundit dhe ndërkohë rezultati para kësaj Qendre Votimi ishte 57 vota në favor të kandidatit Shkëlqim Hoxha. Një mësim kemi nxjerrë nga historiku i gjithë zgjedhjeve në Shqipëri, përsa kohë rezultati është i ngushtë atëhere është testi i institacioneve dhe në këndvështrimin e testit të institacioneve, duke ia shtuar këtë pyetje vetes ne thamë, duhet të shikojmë me hollësi bazën ligjore që rregullon çështjen e votimit në institucionet e vuajtjes së burgimit, e dyta standartet ndërkombëtare. Detyrimi i Republikës së Shqipërisë është të organizojë zgjedhje të lira, të ndershme, të

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

drejtpërdrejta dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare. Çfarë thotë Kodi Civil në nenin 12 dhe neni 14. Neni 12, banimi është vendi ku përsoni për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, vendndodhjes së pasurisë apo realizimit të interesave të veta qëndron zakonisht në të shumtën e kohës. Neni 14 i Kodit Civil, vendqëndrimi i përsonit është vendi ku ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për tu mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, apo raste të tjera të kësaj natyre. Qartazi këto janë institute që janë marr në Kodin Civil, të paktën në dijeninë tonë italian, dhe janë mota mot të përkthyera në Kodin tonë Civil. Egziston një dallim midis konceptit të vendqëndrimit dhe konceptit të vendbanimit. Konceptin e vendbanimit dhe zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë e ka nen 165 i Kodit Zgjedhor, ku thuhet kryetarët e bashkive si dhe këshillat e bashkive, zgjidhen me votim të drejtëpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë. Të dy këto Kode, janë Kode të cilat miratohen me shumicë të cilësuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pra me tre të pestat e tyre. Ku sillet dhe ku është problematika, është problematika e nenit 18, pika 1, ku thekson se ligji 10029 datë 11.05.2009, për Gjendjen Civile, për shtetasit që është shkronja a, shkronja b, kryejnë dënimin në institucionin venddënimit ose qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor, vijojnë shkronjat e tjera, ku qëndrimi përkatës është më i gjatë se tre muaj banim konsiderohet adresa e institucionit përkatës. Pra në kundërshtin dhe vetëm duke vendosur një kritet numerit dhe duke zhvlerësuar institucionin civil, institutin civil të banimit dhe vetqëndrimit, ligji përkatës thekson me një kritet numerik që ndërrohet totalosht thjesht me vetëm tre muaj nga vendqëndrim në vendbanim, kur ky nuk është koncept i të drejtës civile. Tani e kuptojmë praktikën që këto janë të dy ligje dhe si të tilla duhet të jenë të zbatueshme, ne jemi përpara KAS-it, i cili është një organ pothuajse gjyqësor në mënyrën e konpozimit të tij, në procedurën e kryerjes dhe vendimmarjes së kryr,

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

dhe të njëjtën pyetje që shtrojmë përpara një gjykate, e shtrojmë dhe përpara KAS-it. Nëqoftë de konstatojmë qartazi kontraditë midis një ligji me shumicë të cilësuar dhe një ligji me shumicë të thjeshtë, kush zbatohet? Përgjigjen na e jep gjykata dhe Gjykata Kushtetuese e cila ka theksuar që hierarkia e normave juridike është pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe kuptohet që ato që janë në rradhë të parë është Kushtetuta, janë marrëveshjet ndërkombëtare pastaj vijnë ligjet me tre të pestat. Nëqoftëse shihet një kontradiktë midis ligjit me 3/5 dhe ligjit përkatës që miratohet me shumicë të thjeshtë, zbatohet drejtpërdrejtë, sepse e drejta përbën bazën e veprimtarisë së organeve kushtetuese dhe shtetërore në Shqipëri, ligji që miratohet me 3/5, do të thotë që po vendqëndrimi në burgun e Rrogzhinës pranojmë se duhet të kenë sipas dokumentacionit që kemi marr 2 shtetas të cilët kanë vendbanimin e përhershëm në Rrogzhinë, nuk po i futemi 3 apo 4 shtetasve tjetër, nuk po diskutojmë çështjen ishte i ligjshëm vendimi gjykatës apo jo, që lejuan ditën e votimit të bëhet kjo gjë, pra që këta individë të votojnë në burgun e Rrogzhinës. Gjithë të tjerët janë me vetqëndrim, në kuptim të Kodit Civil. Pyetja që lind në këtë rastin konkret është, po mirë kemi listën e zgjedhësve, çfarë është lista e zgjedhësve, lista e zgjedhësve është absolutisht akt administrativ, në kryerjen e funksioneve shtetërore institucionet përkatëse kanë miratuar një akt administrativ. Çfarë është ky akt administrativ? Në konceptin tonë është akt administrativ i pavlefshëm, dhe duke qënë akt administrativ në shumicën tërsore të tij i pavlefshëm, si i tillë nuk duhet të llogaritet në rezultatin përfundimtar. Pse? Sepse neni 108 thekson aktin absolutisht të pavlefshëm bie në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispzitë urdhëruuese të këtij Kodi, dhe neni 110 thekson se pavlefshmëria absolute e këtij akti mund të konstatohet në çdo kohë...

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. Av. Gumi:** ... kryesisht ose me kërkesë nga organi publik, nga organi epror i tij, nga organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative. Në komentarin që SIGMA dhe mos të gaboj Ministria e Drejtësisë i ka bërë Kodit të Procedurave Administrative thekson se sipas pikës 2 të nenit 110: 1) Organ publik që ka nxjerrë ankime, të meta. 2) Organ i tij epror. 3) Organ kompetent për procedurën e ankimit. 4) Gjykata kompetente për mjetet ligjore kundër akteve administrative, mund të konstatojnë pavlefshmérinë absolute të një akti administrativ. Ne vijmë paraqesim ankesën tek organi epror për zgjedhjet dhe kërkojmë konstatimin e pavlefshmérise absolute të kësaj liste zgjedhësish dhe pasojat që ka sjellë kjo listë zgjedhësish në tabelën përfundimtare me përjashtim të atyre 6 (gjashtë) individëve. Kush sipas komentarit konceptohet si kundërshtim? Sipas konceptarit, koncepti kundërshtim kërkon shumë më tepër se sa thjeshtë mosrespektim të ndonjë dispozite ligjore. Duke marrë parasysh pasojat ligjore, termi kundërshtim kërkon një të metë jashtëzakonisht të rëndë dhe serioze. Një e metë e tillë mund të konsiderohet në kundërshtim flagrant me rendin ligjor dhe me vlerat themelore të komunitetit në të cilat bazohet rendi juridik dhe rrjedhimisht do të ishte e patolerueshme që akti të sillte pasojat e synuara juridike. Në këtë kuptim nuk ka rëndësi vendimtare mosrespektimi i një dispozite të caktuar ligjore si e tillë, por vepra kundër rendit juridik në tërësi dhe parimeve të tij kushtetuese. E përmendëm dhe ne e kemi të ezauruar në mënyrë shterruese në tekstin e ankimit, konceptin e Gjykatës Kushtetuese kur vjen puna për të zbatuar një ligj me 3/5 dhe një ligj me shumicë të thjeshtë. Tani po të futeni pikërisht edhe tek ligji me shumicë të thjeshtë, ne gjithashtu kemi problematika të caktuara. Ligji me shumicë të thjeshtë i 2009-ës kërkon miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave. Vendim i Këshillit të Ministrave gjithashtu është miratuar sipas nenit 18, është vendim i Këshillit të Ministrave numër 12/43 datë 11.12.2009 në pikën 6 të së cilit

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

theksohet se “nënpunësi i zyrës i gjendjes civile, për këtë kategori shtetasish, pra për ata që vuajnë ndër të tjera dhe dënimin e institucioneve vendimeve penale, vepron sipas rregullave të përcaktuara nga ministri që mbulon gjendjen civile”. Ministri që mbulon gjendjen civile ka nxjerrë në urdhërin numër 87 të datës 01.02.2013 për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave dhe veprimeve që duhet të kryejnë nënpunësit e gjendjes civile në bashki, njësi bashkiakë, komuna për ndryshimin e vendbanimit, adresës së shtetasve. Në këtë rregullore kemi në figurën numër 12 ose në figurën 11 të tij ku thuhet “pasi plotëson rubrikat e mësipërme zgjedh llojin e vendbanimit, vendqëndrim i përkohshëm” dhe është në databazën e gjendjes civile duke ndryshuar adresën e personit e cila do të jetë adresa e institucionit përkatës. Pra edhe gjendja civile nuk e njeh konceptin e vendbanimit, njeh konceptin e vendqëndrimit të përkohëshëm. Në pikën 10 të tij kur këta shtetas largohen nga këto institucione, zyra e gjendjes civile do të kryejë veprimet pasi të ketë marrë nga institucioni listën e shtetasve që janë larguar pasi përfundon dënimini. Në këtë rast nënpunësi i gjendjes civile do të kryejë ç'rregjistrimin e vendqëndrimit të përkohëshëm duke i kthyer shtetasit në vendbanimin adresën e tij kryesore të mëparshme. Koncepti që është deleguar për tu përpunuar nga ligji për gjendjen civile është pikërisht me aktet nënligjore koncepti vendqëndrimit, nuk kemi koncept të vendbanimit në këtë pjesë. Dua edhe për aspektin që kemi të bëjmë me Gjykatën Kushtetuese të shtrojmë një pyetje dhe pyetja është thelbësore për këtë pikë, besoj edhe për të testuar kriterin e zgjedhjeve të lira, të ndershme edhe demokratike: A mundet që një qendër votimi burg, pra të dënuar me burgim, të përcaktojnë fatin e qeverisjes për katër vitet e ardhshme të një qyteti? E kthejmë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. A përfitojnë të burgosurit të drejtën e arsimit nga pushteti vendor? Jo! A përfitojnë të burgosurit të drejtën për të pasur një shkollë? Jo! Një çerdhe? Jo! Për tu pastruar mjedisi i tyre?

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

Jo! Për të pasur jetë kulturore? Jo! Për ç'farë kanë kontribut këta të burgosur që në një moment të caktuar të jetës së tyre mundet dhe duhet të përcaktojnë fatin e një qyteti. Ky është koncepti ynë! Koncepti që ne gjithashtu e kemi parë është edhe tek praktika ndërkombëtare, të drejtën për të hequr të drejtën e votimit panvarësisht së ka pikpyetje të rënda kushtetuese. Për individ të caktuara që dënohen me vepra penale ne e kemi marrë këtë në dy vende, e kemi marrë nga Italia, Scorcola kundër Italisë dhe nga Mbretëria e Bashkuar, Haris dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar. Pra këtyre j'u është hequr me ligj e drejta për të votuar. Tani pyetja është, po mirë, Mbretëria e Bashkuar që e kemi marrë si burim të ligjit të dekriminalizimit si e rregullon çështjen e të burgosurve? Ju kemi cituar një referencë të Mbretërisë së Bashkuar "House of commons" e cila i është ruajtur dy koncepteve veçanërisht kur kemi të bëjmë me njësi të vogla. Konceptit që lista e personave që vuajnë dënimin në burg prish në mënyrë shkatërruese listën e votuesve në një qendër të caktuar dhe e dyta ruhen shumë sepse nga votimi në këtë qendër mund të përcaktohet fati i këtij qyteti. Cila është zgjidhja?! Mund të jenë pafund zgjidhjet por legjislativi shqipëtar mbështetet për ta parë dhe për ta trajtuar në të ardhmen. Sot ajo që ne diskutojmë është: është zhvilluar një votim në një institucion që është në kundërshtim me Kodin Civil, në kundërshtim me analizë të detajuar edhe me praktikën e rregullimit të regjistrimit të tyre (pra jo vendbanim, vendqëndrim). Konstatojmë pavlefshmërinë absolute sepse janë nxjerrë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruuese të ligjit, cënon rendin kushtetues sepse prish parimin e hierarkisë juridike dhe vijmë këtu përpala një organi ankimore për të konstatuar këtë pavlefshmëri absolute. Për pasojë vlerësojmë se rezultati më i drejtë do të jetë heqja e kësaj qendre votimi ose duke rezervuar atë gjashtëce për çdo rast konkret këta 6 (gjashtë) banorë dy plus katër nuç ndikojnë në rezultat për

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

sa kohë diferenca pa këtë qendër votimi është 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota në favor të kandidatit. Këto ishin shkurtimisht argumentet e mijë!

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Gumi. Fjala për përfaqësues te subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. E. Salianji:** Faleminderit! Së pari do të drejtoj dy pyetje pastaj do të vazhdoj me prapësimet. Pyetja e parë është për administratën, Sekretarin e Përgjithshëm, qendra e votimit burgu Rrogozhinë ka qenë një qendër e kriuar dhe në zgjedhjet e mëparshme si qendër votimi?

**Z. Y. Merkaj:** Po ka qenë e kriuar në zgjedhjet e mëparshme.

**Z. E. Salianji:** Edhe për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinës që është zgjedhur para një viti?

**Z. Y. Merkaj:** Po, 2015, 2019...

**Z. E. Salianji:** Po, është bërë edhe për zgjedhjet para një viti?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk e di! ta verifikojmë...

**Z. E. Salianji:** Përsa i përket ngritjes së kësaj qendre votimi për zgjedhjet e vitit 2023 ka pasur ndonjë ankesë nga subjektet politike ose persona të interesuar në lidhje me ngritjen e kësaj qendre votimi?

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Jo, në dijeninë time jo.

**Z. E. Salianji:** Dakord, edhe një pyetje për palën ankimuese...

**Z. Y. Merkaj:** Më fal se më erdhi përgjigjja edhe në zgjedhjet e 2022 ka qenë si qendër votimi.

**Z. E. Salianji:** Ka qenë si qendër votimi, po! Kjo pyetet në lidhje me argumentin e ngritjes së qendrës së votimit në institucionin e burgimit. Përsa i përket pretendimit tjeter që ka të bëj me rinumërimin dhe rivlerësimin e votave një pyetje kisha për ankimuesit. Në 50% të tavolinave të numërimit që ju keni pasur numëruesh keni ndonjë tabelë të grupit të numërimit të cilët është konstatuar se votat e vlefshme janë quajtur të pavlefshme për kandidatin që ju përfaqëson ose në të kundërt votat e pavlefshme që ju pretendoni janë quajtur të vlefshme për kandidatin e Partisë Socialiste? Të paktën në një tabelë në grup, 50% keni pasur numëruesh dhe keni pasur të gjithë mundësitë për të kundërshtuar edhe për të prapësuar këto pretendime që ju keni këtu.

**Z. I. Kaso:** Unë nuk e kam këtë informacion, nëqoftëse ka në tabela, sepse po ta kisha do ta kisha referuar, sigurisht. Por ajo ç'ka di të them është që një nga arsyet që siç referon edhe KZAZ-ja në momëntin që ka vendosur të mos miratojë me vendim tabelën e rezultatit përfundimtar përsa i përket zgjedhjeve për kryetar bashkie në këtë zonë zgjedhore janë parregullsitë e shumta që kanë ndodhur. Di që janë mbajtur lidhur me shkeljet, veçanërisht ato që u janë evidentuar në qendrën e votimit të JVP-së Rogozhinë, janë mbajtur dhe procesverbale përkatëse që

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

rezultojnë në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, nuk kam dijeni nëqoftëse janë mbajtur procesverbale ose shënimë të tjera në vende të tjera.

**Z. E. Salianji:** Pra Kodi Zgjedhor thotë në pikën 3 të nenit 138, besoj jemi në dijeni të gjithë por po e citoj, “votat të caktuara janë vota të identikuara ose të kontestuara sipas procedurave të neneve 116, 118 të këtij Kodi për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numërimi i tyre gjatë procesit të numërimit”. Gjatë këtij procesi ju keni pasur në të gjithë tavolinat anëtarët e grupit të numërimit por po e marrim atë ç’ka thatë ju 50% , për të cilat është kontestuar vlerësimi ose rivlerësimi. Sipas pikës 2 të nenit 119 të këtij Kodi.

**Z. I. Kaso:** Lexojeni deri në fund, është një gjë që duhet të kesh prapësime megjithatë lexoje deri në fund dispozitën!

**Z. E. Salianji:** Të sqarova dispozitën për të sqaruar pyetjen...

**Z. I. Kaso:** Jo ska nevojë të ma sqaroni, po e citon lexoje deri në fund nëqoftëse nuk e citon bëje si prapësim sepse është debat i kotë.

**Z. E. Salianji:** Përsa i përket argumentit në lidhje me c’farë u relatua nga zoti Gumi në lidhje me Kodin Civil dhe ligjit për gjendjen civile, ne jemi të mendimit që këtu nuk konkuron Kodi Civil dhe ligji për gjendjen civile por këtu kemi Kodi Zgjedhor dhe ligjin për gjendjen civile. Kodi Civil nuk është fare pjesë e këtij procesi! Në Kodi Zgjedhor kemi mënyrën se si ngrihet qendra e votimit, përgatitet lista e zgjedhësve dhe ky është Kodi në të cilët referohet Komisioneri për organizimin e zgjedhjeve, KQZ-ja. Gjithashtu kjo është fusha në të cilën lëviz

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

KAS-i për të parë parregullsitë ose ligjshmëritë që kanë ndodhur në proces. Për arsyen se parimi mbi të cilën mund të konkurojë Kodi Civil është vetëm me të drejtën kushtetuese, me të drejtën që ka çdo shtetas, neni 45 ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Pra ky është i vetmi konkurim dhe me këtë mund të konkurojë Kodi Civil. Është e drejta për të zgjedhur ose për tu zgjedhur dhe është një nen në Kodin Civil që ju thoni është vendbanimi dhe vendqëndrimi dhe këtu mund të rregullohet në bazë të Kodit Civil. Përsa i përket vendbanimit e ka përcaktuar Kodi Zgjedhor është në të njëjtat norma, në të njëjtën vlerë me Kodin Civil nga hierarkia e ligjeve. E ka përcaktuar në mënyrë të qartë se si ngrihet një qendër votimi dhe besoj këtu edhe nga ju nuk u relatua në ankim se ka një kundërshtim me Kodin Zgjedhor, ngritja e kësaj qendre votimi. Nuk u relatua, nuk është bërë asnjë ankesë nga subjektet për ngritjen e kësaj qendre votimi, nuk është bërë ankes për arsyen se me të vërtëtë nuk ka qenë problem kjo qendër votimi deri në daljen e rezultatit. Kjo qendër votimi nuk ka qenë problem në dhjetë pale zgjedhje. Aty kanë votuar të burgosurit, kanë dalë rezultate dhe sot po diskutojmë këtë qendër votimi vetëm për rastin se këtu ndikon në rezultat. Por kjo mund të ishte numëruar edhe e para dhe mund të kishim një qendër tjetër me rezultat shumë më të thellë dhe sdo ishim përballë këtij fakti. E bëjmë edhe debat që të sqarohet por...

**Z. L. Braho:** A bëhet debat apo jo, atë e vendosim ne! Ti vazhdo me...

**Z. E. Salianji:** Patjetër, patjetër e kisha që unë mund të bezdisem nga ndërprerjet pra... Përsa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ai është një vendim i 2007-ës. Ndryshimet ligjore kanë ndodhur në 2010-ën për shkak të këtij rasti që ka caktuar vendqëndrimin dhe banimin e përkohëshëm dhe kjo ka ardhur duke

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

mbrojtur një parim kushtetues, të drejtën për tu zgjedhur. Sot po diskutojmë këtu para KAS-it, po themi me një vendim të KAS-it ne duhet të marrim sot një vendim që nesër ta shkruajmë në ligj, pra duhet të ishte ligji dhe pastaj të jepesh vendimi, por po kalojmë nga e kundërta atë çka kërkon ankimumesi. Të marrim një vendim sot, ta bëjmë praktikë që të dënuarve ne tja heqim të drejtën për të votuar kur kjo e drejtë është një e drejtë kushtetuese dhe kufizimi i kësaj të drejtës është më ligj. Vetë Kushtetuta përcakton rastet në të cilat të dënuarit nuk mund të votojnë. KAS-i vetëm zbaton ligje, nuk ka aftësinë të bëj ligje ose të konstatoj. Është gjykata që bën konstatimin nëqoftëse do të ishim përballë rastit të shfuqizimit të ligjit ose nëqoftëse do të ishim në rastin minimumi mund të hapte një diskutim nëse do të diskutonim qendrën e votimit në momentin kur është ngritur dhe do të shikonim se kush konkuron. Për mendimin tim këtu është Kodi Zgjedhor i cili është kod i posaçëm që irregullon marrëdhënie të posaçme në lidhje me zgjedhjet. Në Kodin Civil janë marrëdhënie juridike, civile që nuk kanë lidhje fare, me procesin zgjedhor. Doja të thoja që pavarësisht kërkimeve që janë në lidhje me këtë qendër unë kërkoj rrëzimin përsa i përket heqjes nga rezultati, se nëqoftëse hiqet kjo qendër nga rezultati ankuesi e di fare mirë çfarë mund të ndodhi dhe nuk e thotë deri në fund. Këtu për shkak të rezultatit ka pavlefshmëri por është një qendër votimi meqenëse thotë neni 116, ndikon në rezultat dhe kjo qendra ndikon në rezultat. Nëqoftëse KAS-i do vendoste ta hiqte këtë qendër nga rezultati... Në Kodi Zgjedhor është përcaktuar fare qartë çfarë ndodh, pra KAS-i dhe organi dhe kolegji nesër që do të diskutojë këtë çeshtje thjesht konstaton që kjo qendër është apo jo e rregullt dhe nuk mund të ndajë aritmetikisht ka qenë banor një i dënuar apo jo. Ne jemi të mendimit që të 118 përsontat të cilët janë dërguar nga Drejtoria e Burgjeve për tu regjistruar ata kanë të drejtë kushtetuese për të votuar. Kjo e drejtë është garantuar nga Kodi Zgjedhor, është implementuar nga gjendja civile (është

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

bërë lista) dhe KQZ-ja ka organizuar procesin si në të gjithë qendrat e tjera të votimit. Përsa i përket rinumërimit dhe rivlerësimit do të thoja që kërkuesi duhet të jetë më i qartë përfletët e votimit të cilët kërkon, duhet të na i ilustrojë se në të cilat qendra votimi konkretisht janë këto fletë votimi. Për sa më sipër kërkojmë rrëzimin e ankimit.


**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Salianji! Para se të vazhdojmë me kolegët kisha një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm. Në rastin e qendrës së votimit 2224/1 që është kjo ë IVP-së Rrogzhinë e kemi procedurën e propozimit nga KZAZ-ja për ngritjen e kësaj QV-je dhe miratimin e saj nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, nuk është e njëjtë me procedurën e Belshit pasi Belshi nuk ishte propozuar, ishte konstatuar ne momentin e fundit. Kjo duke qenë se kemi pasur edhe zgjedhjet e 6 marsit të 2022-shit drejtori i burgut i ka bërë procedurat me shpejt, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile listën e zgjedhësve dhe nuk është dashur miratimi i Komisionerit për këtë qendër të posaçme.

**Z. L. Braho:** Nuk e kuptova! Domethënë qendrën e votimit e ka krijuar Drejtori i Burgjeve?

**Z. Y. Merkaj:** Vendbanimin ose vendqëndrimin e qendrës së votimit e propozon kryetari i njësisë së qeverisjes vendore në bazë të nenit 62 pikë 5 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Po kur është bërë kështu pa procedurën e Komisionerit? Po në 2022-shin si është bërë? Për zgjedhjet e 6 marsit, po njësoj? Po Drejtori i Burgjeve?

**Z. Y. Merkaj:** Unë ju përgjigja edhe një pyetje që bëri zoti Rusmali dje, ka dy praktika, ka drejtor burgjesh dhe jurist që e njohin shumë mirë ligjin dhe e bëjnë kërkesën që përpara se të bëhet lista e zgjedhësve dhe e krijojnë qendrën e votimit dhe listën e zgjedhësve e bëjnë që kur është momënti 40 ditë para për korigjimin e listës se zgjedhësve. Ka burgje të tjera që e neglizhojnë nuk e di, për mosnjohje ligji ose për arsyet e tij, që e bëjnë në momentin e fundit siç ka qenë edhe rasti i Belshit, dje. Ky ka qenë rasti që e ka bërë përpara kohe duke qenë se ka pasur edhe zgjedhjet e 6 marsit dhe ka pasur procedurë më të qartë dhe e ka bërë sipas ligjit kërkesën edhe për zgjedhësit edhe për krijimin e qendrës së votimit të posaçme.

**Z. L. Braho:** Dispozita që ju referoni ka të bëjë me caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. L. Braho:**... dhe kjo nuk është qendër votimi, është qendër votimi në një ambient special, siç është IEVP-ja Rogozhinë, dhe Kodi Zgjedhor ka dispozitë specifike, kurse 62-shi, është për qendrat e votimit në aspektin e përgjithshëm, qendrat e votimi, si gjithë qendrat e tjera të Shqipërisë.

**Z. Y. Merkaj:** Në të gjitha rastet thotë vendndodhjen e qendrës së votimit, edhe kjo vendndodhje e qendrës se votimit, pavarësisht se ndodhet në burg është përcaktuar vendndodhja e qendrës së votimit në ambient të posaçëm, që është burgu.

**Z. L. Braho:** Qendra e votimit e burgut, gjithmonë në burg do të jetë, se nuk mund të jetë jashtë. S'besoj se ka rendësi për të përcaktuar Kryetari i Bashkisë se ku do të jetë qendra e votimit e burgut, se ajo normalisht në burg do të jetë, por ajo që dua të kuptoj unë është që, duke qenë se dispozitat kanë një parashikim specifik për këto qendra, duhet vendim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i propozuar nga KZAZ-ja. Në këtë rast juve pohoni që nuk ka një të tillë

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, më fal, se më duket se po ngatërrrohem...

**Z. L. Braho:** Se dëgjo, u bë pyetja nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste n.q.s ka ankim nga koalicioni “Bashkë Fitojmë” apo ndonjë subjekt tjetër në lidhje me këtë vendim, pra me vendimin për krijimin e kësaj KQV-je, ndërkohë ku na rezulton që nuk ka fare vendim për krijimin e kësaj KQV-je. Çfarë duhet të ankimonin këto palët e tjera në këtë rast?

**Z. Y. Merkaj:** Më fal se më duket se po ngatërrrohem. Neni 43, i Kodit Zgjedhor përcakton kompetencën e Komisionit të Administrimit të Zonës Zgjedhore për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

propozimin e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit, jo për vendndodhjen, vendndodhjen e përcakton Kryetari i Bashkisë, kurse KZAZ-ja kërkon vetëm emërimin e anëtarëve të qendrës së votimit, të kësaj qendre votimi, neni 43.


**Z. L. Braho:** Tani më duket se nuk po kuptohemi, se edhe ai që nuk po kuptoni jeni ju, në raport me ketë që po them unë. Tani, çfarë duhet të ankimonin ata? Nëse pala ankimumese do të ngrinte pretendimin në lidhje me këtë qendër votimi, çfarë mund të ankimonin për këto zgjedhje? Se supozojmë rastin se ishte mbyllur burgu i Rrogozhinës, dhe meqenëse ka qenë 2022-shi, do vazhdonte të kishte një QV atje, dhe pse s'do të kishte në burg? Ideja e Kodit Zgjedhor është që qendrat duhet të krijohen në çdo rast që ka zgjedhje, dhe çdo rast që ka zgjedhje e krijon Komisioneri sipas vetë Kodit, jo drejtori i burgut, sepse vendimin e drejtorit të burgut nuk e ankimon dot njeri pastaj.

**Z. Y. Merkaj:** Nuk tha njeri e krijoi drejtori i burgut. Drejtori i burgut ka bërë kërkesën Kryetarit të Bashkisë dhe Gjendjes Civile, për listat e zgjedhësve dhe përvendndodhjen e qendrës së votimit.

**Z. L. Braho:** Mirë dakord jam i qartë, ka ndonjë pyetje nga kolegët? Po keni pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm?

**Z. I. Kaso:** Jo, nqs mund të saktësoj një gjë që ngeli pa u thënë, në lidhje me këtë, dhe që u ngrit në formë prapësimi nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste, thjesht t'ia vë në dijeni KAS-it, para se ju të filloni pyetjet. U tha lidhur me qendrën e posaçme, gjithmonë, dhe nuk po i kthehem arsyetimit që bëri avokati i kandidatit. Lidhur me dispozitën urdhëruuese të Kodit Civil, raportin e saj në lidhje me dispozitën e gjendjes

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

civile ose me parashikimet që ka Kodi Zgjedhor, ashtu sikundër do të doja që të jetonim në një vend që të zgjidhnik ligjet që do të zbatonim, siç thotë përfaqësuesi i Partisë Socialiste që zgjedhim të zbatojmë Kodin Zgjedhor dhe ligjin për Gjendjen Civile, po Kodin Civil e lëmë mënjanë, përfat të keq nuk e kemi, ose mënyra si e kuptoj unë gjithë kornizën ligjore është që nuk e kemi këtë luks. Ose duhet zbatuar nëse parashikon urdhërimet, ose nuk duhet zbatuar. Po të zgjedhim këtë zbatojmë është pak paradoksal, megjithatë meqenëse u referua që duhet zbatuar Kodi Zgjedhor, në nenin 44, ka një parashikim shumë interesant lidhur me kriteret si hartohet lista e zgjedhësve, sepse theksi që vuri, të paktën me sa e kuptova unë zotin Gumi me fjalët e tij kishte të bënte me parregullsinë që në momentin e hartimit të krijimit të kësaj liste, të cilat çojnë në pavlefshmëri të sajë, dhe rrjedhimisht gjithë efekteve që ka prodhuar ajo. Neni 44 e ka qartësisht në pikën “d”, të tij të shprehur faktin që kriteret përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve janë sipas pikës “d”, “Të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit”, pra vendbanimin në momentin që hartohet lista, ta ketë në atë territor. Tani çfarë na thotë drejtori i burgut me informacionin që ka ardhur ditën e djeshme, që sikundër u referua nuk është fare kërkesë përgritjen e një institucioni të posaçëm, por është vetëm dërgim dokumentacioni që i bëhet Bashkisë Rrogozhinë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke ngritur edhe pyetjen dhe dilemën që ky drejtor burgu siç e referoi zoti Gumi, lidhur me faktin nqs këta zgjedhës duhet të votojnë apo nuk duhet të votojnë. As e ka marrë të mirëqenë dhe as e imponon, pikërisht ngrë shqetësimin dhe në materialin që i bashkëlidh në datën 21.03.2023, pra, vetëm 13 ditë përpara daljes së listës përfundimtare të zgjedhësve, në bazën e së cilës kanë votuar këta zgjedhës, i gjithë materiali që bashkëlidh, duke përshkruar në mënyrë të detajuar numrin e të dënuarve: emër, mbiemër, atësinë e tyre, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin në një kolonë të caktuar, rezulton se nga 118

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

shtetas vetëm 2 prej tyre e kanë vendbanimin, në datën 21.03.2023 në Bashkinë Rrogozhinë, pra nuk jemi në asnjë nga kriteret që parashikon, qoftë edhe ligji për Gjendjen Civile, qoftë edhe akteve ligjore që e detajojnë atë ligj, qoftë edhe detyrimet që duhet t'u lindin institucioneve në hipotezën që ngre kolegu i Partisë Socialiste që këta të dënuar e kishin vendbanimin dhe rrjedhimisht dhe të drejtën për t'u përfshirë në listë në atë zonë zgjedhore, në atë qendër votimi. Këtë nuk e them unë, si përfaqësuesi i ankuesit, i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, nuk e thotë kolegu Gumi, si përfaqësues i kandidatit, e thotë vetë personi i ngarkuar nga ligji me të drejtën për të referuar saktësisht të dhënat, se si ishte gjendja e vendbanimit të këtyre shtetasve, në raport me listën përfundimtare të zgjedhësve, dhe rrjedhimisht me të drejtën, ose jo për të votuar në këto palë zgjedhje, informacion që përfat të mirë e disponojmë zyrtarisht dhe do t'ia vë në dispozicion KAS-it. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit! Po zoti Koli.

**Z. K. Bele:** Më fal se diskutimi për palët, një diskutim i hollë për debatin midis hierarkisë së ligjeve dhe të drejtën tonë si KAS, deri ku shkojmë. Unë doja të kthehesha prapë tek ai dialogu pak praktik i Sekretarit se na ndihmon të kuptojmë procesin. Duke pasur në konsideratë dhe rastin e Belshit, dje, ku në një situatë të ngjashme u relata që në qendrën, në atë që njihet si burgu i Fushë-Kosovës, kishte të njëjtën situatë, që kishim një qendër votimi historike edhe për zgjedhjet vendore, me sa kuptoj është edhe këtu. Me sa kuptoj duhet të jetë në të gjitha bashkitë ku ka burgje. Tani në terma praktike, sepse qartësisht rasti i krijimi të këtyre qendrave është rasti i ndryshëm nga gjithë qendrat e tjera në një zonë zgjedhore, ose që mbulohet nga një KZAZ, apo ka më shumë bashki, se sa një KZAZ. Në kuptueshmërinë time, bashkia përcakton vendndodhjen, dhe në historikun e KQZ-së

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

ka pasur edhe debate në lidhje me administratën vendase ka pasur edhe debate në lidhje me madhësinë e vendit, ankimet e palëve, nëse i plotëson kushtet kriteret dhe ky rast, ky moment kur kryetari përcakton vendndodhjen i bëhet i ditur KZAZ-ve, apo jo? Është korrekte kjo? Pra, KZAZ-ja në rastin në fjalë, në Rrogozhinë, i është komunikuar nga kryetari i bashkisë apo nga i ngarkuari, kush ka dhënë komunikimin, i është komunikuar lista e QV-ve për gjithë bashkinë. E qartë?

**Z. Y. Merkaj:** E QV-ve, dhe lista e zgjedhësve për çdo QV.

**Z. K. Bele:** Në këtë komunikim duhet të këtë qenë dhe kjo qendër votimi?

**Z. Y. Merkaj:** Po. Në rastin e Rrogozhinës, po, ka qenë.

**Z. K. Bele:** Nëse do të kishte një pretendim, a ishte ky momenti që ngrihesh ky pretendim? Si për çdo zonë zgjedhore nga përfaqësuesit në KZAZ, apo palë të tjera të interesuara?

**Z. Y. Merkaj:** Po patjetër, Komisioneri, ose në mbledhjet publike të Komisionerit bëhen edhe debate për caktimin e Qendrave të Votimit në ambiente private, ku marrin pjesë edhe palët. Zakonisht marrin pjesë palët që kanë anëtarë në qendrat e votimit dhe ata dhe i kundërshtojnë ose kemi pasur raste që kanë kundërshtuar emrin e personit, të pronarit të shtëpisë, dhe thotë që .... ky ka qenë debati .....dhe debati që bëhet për qendrat e votimit.

**Z. K. Bele:** Pra, për ta përbledhur, 7 anëtarët e KZAZ-së, apo sa anëtarë ka pasur ajo KZAZ, janë komunikuar mbi listën e qendrave të votimit, dhe kjo listë i është

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

përcjellë dhe KQZ-së. Apo jo? Kështu është procedura. Dhe në këtë fazë nuk kemi ndonjë kontestim apo ankimin lidhur me .....

**Z. Y. Merkaj:** Jo nuk kemi.

**Z. K. Bele:** Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Tani, meqë po merremi pak me këto, edhe në atë ankimin tjetër, kam një pyetje për palën ankuese: Ju, qëndrimi juaj është që ju jeni që të burgosurit nuk duhet të votojnë?- është pyetja e parë, apo duhet të votojnë? Dhe pyetja e dytë është që: Nëse të burgosurit duhet të votojnë, ku mundet dhe ku duhet të votojnë të burgosurit sipas jush? Duke pasur parasysh që si mund të kryhet dhe ky votim? Faleminderit!

**Z. V. Gumi, avokat:** Eh, me dëshirë donim të bënim rolin e ligjbërësit pozitiv në këtë aspekt. Një nga metodat, patjetër që të burgosurit duhet të votojnë. Praktika ndërkombëtare që të burgosurit votojnë është me dy mënyra: 1. ose votojnë në vendbanimin e tyre të mëparshëm përpara se të futeshin në institucionin e IEVP-së, ose e dyta me deklarim (unë po them praktiken angleze) duhet t'i thonë komisionit se ku kanë në plan të jetojnë pas daljes nga burgu. P.sh. mund të jenë martuar, bashkëshortja ka blerë diku tjetër një shtëpi, do të vejë të jetojë pas daljes nga IEVP-ja, atje në atë shtëpi. Këto janë dy format. Metodat, mënyra se si realizohet kjo e drejtë votimi i takon këtyre institucioneve. Vende të ndryshme kanë lloje të ndryshme: nëpërmjet Proxy, nëpërmjet kutive të votimit, nëpërmjet votimit elektronik apo me elementë të tjera. Në situatën aktuale që ndodhemi, ne jemi kandidatë të cilët vuajmë pasojat, që na ka ardhur si pasojë e një vendimi të padrejtë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

Nëse ata persona duhet të votojnë, ky nuk është problemi i kandidatit, është problemi i administratës shtetërore që duhet ta mendonte dhe ta kishte zgjidhur kohë më përpara këtë gjë. Një drejtor burgu thotë: "Kujdes në 21 mars, duan të votojnë apo jo?" Kodi Civil është dispozitë jo deleguese Neni 38 thotë: "Likuidimi i personit juridik që falimenton rregullohet me ligj"; neni 152, "Llojet e pasurisë publike caktohen me ligj"; neni 163, pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në kohë dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë" As te vendbanimi, as te vendqëndrimi, ne nuk kemi delegim. Dhe, për më tepër ky delegim sikundër përmendëm pak më parë është në kontraditë antiligjore me vetë Ligjin për Gjendjen Civile sepse nëpunësi i gjendjes civile ka kategorinë: vendqëndrimi të përkohshëm. Vendqëndrim i përkohshëm. Pyetja nëse duhet të votojnë? – Po. Nëse ku nuk duhet të votojnë? E theksojmë, nuk duhet të votojnë në qendrën e votimit, n.q.s nuk janë banorë të asaj bashkie. Si mundet të rregullohet kjo gjë? Shteti duhet ta rregullojë.

**Z. E. Lako:** Në gjendjen e akteve aktuale, në opinionin tuaj ku duhet, dhe ku mundet të votojnë sipas legjislacionit shqiptar? Praktikisht, d.m.th. një i burgosur që kryen dënimin në institucionin e riedukimit në Rrogozhinë, ku duhet të votojë sipas jush?

**Z. V. Gumi, avokat:** Mund të votonin në burgun e Rrogozhinës, me kushtin që: sikundër bënë 4 veta që morën vendim gjykate të posaçëm, të bënин dhe 116 të tjerë. 2 ishin në vendbanimin në Rrogozhinë, 116 të tjerë janë futur në kundërshtim me ligjin. Nëse dëshirojnë të votojnë, duhej të merrnin deri ditën e votimit, vendim gjykate për të votuar në qendrën e burgut, sikundër bënë 4 veta, sipas informacionit të drejtorisë së burgjeve. Lista e zgjedhësve që kanë përdorur për votim është akt absolutisht i pavlefshëm. Është bërë në kundërshtim me dispozitën urdhëruar të Kodit Civil që të mos t'i kthehem përsëri.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. E. Lako:** Faleminderit, e qartë.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, ka pyetje nga kolegët e tjerë? Nuk ka pyetje. Dakord! Në lidhje me ato provat që keni për pjesën e rivlerësimit të rinumërimit, shkresën që keni nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

**Z. I. Kaso:** Po, i nderuar, kemi atëherë pasqyrën tonë përbledhëse me detajimet, fotografitë përkatëse të sipas tabelës tonë. Kemi kthimin e përgjigjes nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të cilës i bashkëngjitet shkresa e dërgimit të dokumentacionit e drejtorit të IEVP-së, Rogozhinë, së bashku me gjithë anekset në të cilën jepen të dhëna të detajuara të gjithë zgjedhësve, duke përfshirë edhe të dhëna shumë të rëndësishme të vendbanimit të tyre, bashkangjitur me listën e zgjedhësve të cilët kanë votuar në këtë qendër votimi, së bashku me dispozitivin e tre vendimeve të gjykatave për shtetasit të cilët janë lejuar të votojnë me vendim gjykate në këtë qendër të posaçme, tej listës së zgjedhësve.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Një sqarim i nderuar relator, në lidhje me atë shkresën që sapo ju përcollëm, është një kthim përgjigje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, që më është adresuar mua, ndaj një kërkese që unë si përfaqësues i koalicionit e kisha bërë më herët dhe po ta vini re në fund të shkresës, përgjigja ka të bëjë pikërisht me Rogozhinën. Dhe aty jepet dhe shpjegimi i pyetjes tuaj, i nderuar relator, se si është krijuar qendra. Baza ligjore është nen 44 dhe 62 i Kodit Zgjedhor, dhe pikërisht dhe kolegu Kaso, me parë pikërisht nenit 44 iu referua... të Kodit Zgjedhor, nen 44, pika "d", ku Kodi Zgjedhor shprehet sërisht për

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

vendbanimin, pra, vetë aty mund ta kuptioni edhe ju më qartë si qëndron puna, plus ka edhe një element tjetër shumë të rëndësishëm, që duhet ta theksoj, të nderuar, tek përgjigjja, thuhet që nuk ka vendime gjykate për të lejuar votuesit. Ne nuk na u përcoll, por i morën në një rrugë tjetër, por KQZ-ja, thotë që nuk ka. Pra, si kanë votuar këta të burgosur? Këtu është gjithë pikëpyetja.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit zoti Nuri! Në fakt neni 62 është i qartë. Neni 62 flet për qendra votimi me jo me pak se 300, dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës, ndërkokë kjo është me 180 zgjedhës, ndaj dhe unë jam i paqartë se ç'lidhje ka neni 62 me qendrat e posaçme, megjithatë, pavarësisht kësaj, ne e arsyetojmë vetë këtë çështje.

**Z. K. Bele:** Me fal, vetëm një pyetje kisha z. Nuri. Kjo ka të bëjë me kërkesën tuaj për të marrë prova, apo është ndonjë.....

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Po për të marrë prova.

**Z. K. Bele:** Është kërkuar të merret ajo CD-ja, harddisku, pra ju keni kërkuar pamjet filmike?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Jo vetëm pamjet filmike i nderuar, por kemi kërkuar zyrtarisht edhe listën dhe vendimet, eventualisht vendimet e gjykatave për të lejuar ...

**Z. L. Braho:** Po, dhe ju ka shpëtuar pse s'u jepen vendimet e gjykatave, kaq. Apo do përdorim edhe këtë si argument ligjor për.... Ishte thjesht ilustrim i mënyrës si është ngritur qendra e votimit, në bazë të nenit 44, pra kritereve të vendbanimit, për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

të theksuar të njëjtin argument, të cilën siç e sqarova edhe me gojë, të mos t'i kthehem më. Faleminderit!

**Z. E Salianji, përfaqësues i PS-së:** Për sa i përket, është një shkresë që është e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, pra, nga bashkia Rrogozhinë, ka ardhur në bazë të kësaj kërkesës, që është bërë nga Drejtoria e Burgjeve, më pas në dt. 31.03.2023 ka ardhur një shkresë nga Bashkia Rrogozhinë drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për dijeni Perfektit, ku bashkëngjit listën në dt. 31.03.2023. Dhe kjo shkresë ndodhet pranë KQZ-së. Unë po jua depozitoj si fotokopje dhe ju mund ta gjeni këtë. Ku paraqet listën atë çka ne po diskutojmë sot në bazë të kompetencës që ka Kryetar i Bashkisë, i paraqit për dijeni KQZ-së dhe Perfektit, listën e të dënuarve të cilët .....

**Z. L. Braho:** Kjo është provë që po e paraqisni ju?

**Z. E Salianji, përfaqësues i PS-së:** Është në KQZ, është në institucion, është shkresa që duhej të ishte sot nga stafi i KQZ-së . Është praktika që ka bashkia Rrogozhinë me institucionin e KQZ-së

**Z. L. Braho:** E paskeni ju, kështu që ... Na e jepni ta shohim pak këtë shkresën. Po zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Lidhur me këtë çështjen e votimit të burgosurve, për zotin Gumi, eventualisht edhe për zotin Kaso, kush mund të më japë përgjigje. Teza juaj është që duhet konstatuar pavlefshmëria e aktit administrativ, duke nënkuptuar akt administrativ listën e zgjedhësve. Mbi këtë logjikë dhe mbi arsyetimin tuaj për

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

Kodin Civil, do të thotë që duhet konstatuar pavlefshmëria e të gjitha akteve administrative kudo në zonat zgjedhore ku ka burgje?

**Z. V. Gumi, avokat:** Në përgjigje të kërkesës tuaj, në komentarin që i bëmë dispozitës, në mos gaboj, 112, theksohet kush mund të konstatojë në procesin ankimor këtë gjë. Dhe ne, shfrytëzuam faktin që jemi në proces ankimor, kemi paraqitur kërkesë ankimore dhe kërkojmë vendimmarjen e KAS-it, në lidhje me këtë. N.q.s kjo, do të shtrihet në një rang më të gjerë në Shqipëri, ose jo, kjo ngelet një vendimmarje që i takon KAS-it, por në çdo rast do të duhet të këtë një iniciativë procedurës ankimore, pra në momentin që ka një vendimmarje të formës së prerë dhe të paankimueshme në lidhje me këtë gjë, besoj se asnjë organ administrativ nuk ka mundësi për të vepruar për këtë gjë. Organi administrativ, si instance ankimore është vetëm kur shqyrton ankimin dhe këtë, ose me kërkesë, ose me prapësimin e palës që kërkon. Për ato të gjitha, të cilat kanë mbyllur procesin e ankimit, kanë vendime administrative, ose vendime gjyqësore të formës së prerë, jo, nuk mund të bëhet një gjë e tillë sepse është gjë e gjykuar.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit! Tani kisha një pyetje prapë për administratën. Kjo shkresa që na u vu në dispozicion nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste dhe kjo është shkresë përcjellëse, i është drejtuar KQZ-së dhe Komisionerit, për dijeni Perfektit të Qarkut Tiranë. Ka ndonjë kthim-përgjigje nga KQZ-ja në lidhje me këtë shkresë? Çfarë ka ndodhur pas kësaj? Se këtu është shkresa, dhe bashkëlidhur ca emra, kaq ka.

**Z. Y. Merkaj:** Ne kërkojmë pak kohë që ta verifikojmë.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. L. Braho:** Po, patjetër. Perfaquesuesët e ankimuesve meqë na sollët ca prova, përveç fotografive, janë dhe disa shkresa, ju lutem na i shpjegoni me pak fjalë secilën prej tyre. Pra, është një shkresë e IEVP-së, Rogozhinë që ka një listë emrash dhe vendbanime.

**Z. I. Kaso:** Po, shhkurtimisht, kemi depozituar 3 shkresa: shkresa e parë është përgjigjja e kérkesës tonë, që i kemi bërë IEVP-së, si subjekt zgjedhor, për atë që i përket 2 çështjeve ankimore që kemi ngritur që kishin problematikë të ngjashme, por jo të njëjtë që ishte ajo e burgut të Lushnjes, dhe të Bashkisë së Belshit dhe të burgut të Rogozhinës që i përket bashkisë së Rogozhinës dhe shpjegime të shkurtra që jepen nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke i bashkangjitur shkresës së tyre referencën konkrete që ka ardhur në rastin konkret për sa i përket IEVP-së Rogozhinë që është dokumenti i dytë, që është shkresa që drejtori i IEVP-së Rogozhinë, me 21 mars ne mos gaboj i drejton Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Bashkisë Rogozhinë ku i vë në dijeni faktin që në atë ditë ka një listë të bashkangjitur të burgosurish që në teori lejohen të votojnë, pra, nuk hyn në ato përcaktimet kufizuese të nenit 2 të ligjit “Për dekriminalizimin”, që nuk i lejon shtetasit për një periudhë të caktuar që të votojnë. Pra, i bën me dije, këto dy institucione që janë 118 shtetas me të drejtë vote, por ngre pikëpyetjen n.q.s duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë vote në këtë IEVP, ose në këtë zonë zgjedhore për këto zgjedhje, pasi qartazi, nga mënyra se si drejtori i IEVP-së, e interpretion ligjin, dispozitat ligjore nuk japid përgjigje të saktë n.q.s këta zgjedhës duhet të votojnë në këtë bashki, pra në bashkinë objekt ankimi, bashkia Rogozhinë, për këto zgjedhje, dhe i bashkëngjit listën e detajuar të cilës neve iu referuam, e cila përveç gjeneraliteteve të tyre: datës së lindjes, vendit të lindjes, përmban dhe një kolonë të rëndësishme, e cila është vendbanimi i atyre shtetasve, si i rezulton drejtorisë së

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

IEVP-së në datën 21 mars, pra 13 ditë përpara mbylljes së listës përfundimtare të zgjedhësve, ku konstatojmë që jo më shumë se 2 shtetas janë banues të Bashkisë Rrogozhinë, përkundër 118 shtetas që kanë në teori të drejtën e votës, por sipas nesh, dhe sipas legjislatorit besoj, në vende të ndryshme, qartazi, jo në Bashkinë Rrogozhinë. Dokumenti i tretë që kemi bashkangjitur, që na ka ardhur përsëri nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilës i ka shkuar nëpërmjet IEVP-së Rrogozhinë, është lista e zgjedhësve, të cilën ka përdorur Komisioni në momentin e votimit në këtë IEVP, të cilës i bashkëngjit, por jo në mënyrë të plotë, duke vënë në vetëm diapositivin, faqen e fundit të vendimit të gjykatës për tre shtetas, të cilët janë lejuar të votojnë mbi këtë listë, me vendim gjykate. Është mënyra se si na ka ardhur, si na janë përcjellë. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Tani, kam edhe një pyetje nuk e di kush mund të ma japë përgjigjen, ndoshta kandidati? Tani u citua disa herë që kjo kutia, pra qendra e votimit, 2224/1, është numëruar e fundit nga KZAZ-ja, por ndërkohë që rezulton që sipas numërtimit kanë qenë 60 kuti të tjera që duhej të ishin numëruar pas kësaj. Keni ndonjë informacion se pse KZAZ-ja, e ka cenuar radhën e numërimit të Qendrave të Votimit sipas Kodit Zgjedhor, duke mos i numëruar sipas renditjes, por këtë e kanë lënë të fundit?

**Z. Sh. Hoxha:** E fundit është numëruar dhe s'e kam idenë!

**Z. V. Gumi, avokat:** Besoj për këtë gjë duhet pyetur KZAZ-ja, por konfirmohet që Qendra e Votimit e burgut të Rrogozhinës është numëruar e fundit, dhe rezultati paraprakisht dihej nga të gjithë besoj se ishte 57 vota para... Duhet ta pranojmë se jetojmë në Shqipëri dhe besoj se kjo nuk është vetëm në këtë pjesë, në krahasim me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

transparencën, me mënyrën se si zhvillohen votimet në një qendër jashtë IEVP-së, dhe në një qendër brenda IEVP-së, ka një dallim thelbësor. Do të thotë është më vulnerabël edhe ndaj presionit, ashtu sikundër statistikat, informacionet tregojnë që psh, babai i kandidatit punonte në IEVP-në Rrogozhinë, dhe ne nuk konstatojmë asnjë legjislacion për konfliktin e interesit brenda këtyre institucioneve për ta shmangur këtë gjë. Pra, do të thotë që ishte surprizë, ishte mjet për të përbysur rezultatin sepse kishte siguri.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Gumi! Zoti Merkaj ndonjë përgjigje për atë pyetjen, apo kërkonit akoma kohë? Për këtë shkresën që u ka ardhur nga Bashkia Rrogozhinë

**Z. Y. Merkaj:** Po ka shkuar Ina poshtë ta....

**Z. L. Braho:** Ah, ok. Po dakord!

**Z. I. Rusmali:** Zoti Kaso, imagjinoj unë, por mund ta thotë dhe zoti Gumi, në analizën që ju i keni bërë situatës te lista e zgjedhësve të burgut të Rrogozhinës, keni bërë vlerësimin, sa kjo listë ka qenë në përputhje me dispozitën e nenit 18 të ligjit për Gjendjen Civile, apo s'jeni marrë fare me këtë?

**Z. I. Kaso:** Faleminderit i nderuar. Është një e dhënë, e cila nuk na është dhënë në pasqyrën që i bashkëngjitet informacionit që vjen nga IEVP-ja e Rrogozhinës, pra nuk konstatojmë që të këtë një informacion më të detajuar se ky që kemi vënë në dispozicion, lidhur me faktin që prej sa kohësh ndodheshin këta të dënuar aty. Në përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në përbledhje, për sa i përket kësaj IEVP-je, meqenëse kërkesa ishte bërë për më shumë se një IEVP, flitet që në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

këtë IEVP, ka ndodhur transferime dhe ndryshime të burgosurish. Pra, flitet për .... që nga momenti i daljes së listës përfundimtare të zgjedhësve në këtë IEVP, siç ka rezultuar në datën 4 prill, përsëri ka pasur ndryshime deri në ditën e zgjedhjeve, pra ka të dënuar, të cilët janë liruar dhe ka të dënuar që janë transferuar, çfarë flet dhe demonstron për një lëvizje të shpeshtë të dënuarve në këtë IEVP, por nuk konstatojmë, ose të paktën nga përgjigjet që na është vënë ne në dispozicion nuk kemi informacion më të detajuar se kaq.

**Z. V. Gumi, avokat:** Sikundër e përmendi pak më përpala zoti Ivi Kaso, por për ta pontifikuar më shumë, në përgjigjen që ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, është konkretisht shprehja “nga 01.01.2023 deri në 14.05.2023, janë 23 të transferuar me të drejtë vote”. Kjo është përgjigja zyrtare që na kanë sjellë ata. Ndërkohë te tabela që bashkëshoqëron ka një rubrikë të veçantë që thotë “data e arrestimit”, dhe këtë gjë, ne nuk e kuptojmë dot, nëse është data e arrestimit vendimi i gjykatës që është masa e sigurisë me arrest, apo është momenti kohor kur ky individ ka ardhur në burgun e Rrogozhinës. Sipas statistikës kjo është e dhëna, dhe çuditërisht vazhdon deri në datën 14.05.2023, kur kriteri është 3-mujor, në shkelje të ligjit, ndërkohë informacionin statistikor ne nuk e nxjerrim dot, sepse tabela përmban datën e arrestimit që ne nuk na thotë asnje gjë.

**Z. L. Braho:** Faleminderit!

**Z. Y. Merkaj:** Po, atëherë kjo kërkesë është konsideruar si vënie në dijeni të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe s'ka pasur nevojë për përgjigje, pasi kompetencën e ka Kryetari i Bashkisë për të caktuar vendndodhjen e qendrës së votimit në bazë të nenit 62, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*  


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Merkaj. Edhe një herë pala ankuese i qëndron kërkesës për rivlerësim dhe rinumërim të gjitha Qendrave të Votimit të bashkisë Rrogozhinë, apo jo?

**Z. I. Kaso:** Po, i nderuar, por duke kërkuar gjithashtu sipas nenit 136 , pika 1, “c” marrjen e provës, e cila përbahet në zarfin e fletëve të pavlefshme dhe në zarfet e fletëve të vlefshme të ndarë përkatësisht për kandidatët në të gjithë kutitë e qendrave të votimit Faleminderit.

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Atëherë do të na lini 5 deri në 10 minuta kohë, sa të shprehemi në lidhje me këtë kërkesë dhe do të ju njoftojmë.

**Rifillon Seanca**

**Ora 15:47**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Çelim edhe një herë seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 80. KAS u tërhoq për vendim në lidhje me kërkesën për rivlerësimin dhe rinumërimin të qendrave të votimit, që i përkasin KZAZ-së, që mbulon Bashkinë e Rrogozhinës, dhe pasi u konsultuam me shumicë votash vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit ankimues të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, megjithatë në zbatim të nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, duke qenë se koalicioni, subjekti zgjedhor e bëri kërkesën zbatuar në nenin 136, pika 1, shkronja “c”, dy anëtarë të KAS-it, konkretisht, unë dhe zoti Elvis Çefa, i kërkojmë KQZ-së që në cilësinë e provës të paraqesë të gjithë kutitë e qendrave të votimit për kandidat për kryetar të bashkisë Rrogozhinë në mënyrë që të këqyret në cilësinë e provave dhe të vlerësohen të gjitha fletët e votimit. Kështu që i kërkoj administratës së KQZ-së, që të bëjë gati


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

një shkresë, ku ne i kërkojmë pikërisht këtë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për këtë arsy, ne e pezullojmë seancën për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkese ankimore, dhe do të caktojmë datën se kur do të vijojë seanca. Atëherë, seanca për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkese ankimore do të caktohet ditën e hënë në orën 13:00. KQZ-ja gjithashtu të marri masat për ngritjen e grupeve të numërimit në lidhje me këto qendra votimi dhe infrastrukturën e nevojshme, po ashtu subjektet zgjedhore të marrin masa që të sjellin vëzhgues, duke rakorduar edhe me administratën e KQZ-së në lidhje me nunrin e tavolinave të numërimit në mënyrë që të ketë nga një vëzhgues për çdo tavolinë numërimi. E deklarojmë seancën të mbyllur!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**31.05.2023  
Ora 15.53**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kérkesave ankimore nr. 81 dhe nr. 86, subjektet  
ankuese koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe Partia Lëvizja e Legalitetit”**

**PJESËMARRJA:**

- KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- Stafi i KQZ-së: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema,  
Znj. D. Alimemeti
- Parti politike BF (F. Nuri, A. Hoxha), PS (A. Skënderi, M. Legisi)  
PLL (R. Ramaj, N. Sulaj)
- Të tjerë: KRIIK

**Z. E. Lako:** Fillojmë seancën publike për shqyrtimin e kérkesës ankimore nr. 81, datë 23.5.2023, të depozituar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, si dhe kérkesën nr. 86, datë 25.5.2023, të depozituar nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit, me objekt të përbashkët: “Kérkesë për ndryshimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit të Bashkisë Kamëz për QV-të nr. 1575/00 dhe nr. 1597/02, që i përket subjektit zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit, si dhe kundërshtimin e vendimit nr. 536, datë 20.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kryetarë të bashkisë dhe për këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

Bashkia Kamëz për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, “Përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar bashkie dhe për këshillin bashkiak Kamëz”. Kjo kërkesë është bërë me këtë subjekt nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”. KAS-i vendosi bashkimin e këtyre dy kërkesave ankimore me vendim të ndërmjetëm nr.154, datë 26.5.2023 dhe caktoi datën e shqyrtimit të tyre të përbashkët sot më 30 maj, ora 15.00. Sipas shortit të hedhur, relator i kësaj çështje jam unë, Elvin Lako. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes, verifikojmë palët pjesëmarrëse në këtë proces. Ju lutem, për koalicionin “Bashkë Fitojmë”.

**Z. F. Nuri:** Për koalicionin “Bashkë Fitojmë” Franci Nuri prezent.

**Z. A. Hoxha:** Arjan Hoxha prezent.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Për Partinë Lëvizja e Legalitetit.

**Z. R. Ramaj:** Avokat Redi Ramaj me autorizim.

**Z. E. Lako:** Ju lutem, dorëzoheni aty.

**Z. N. Sulaj:** Nazif Sulaj, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak në Kamëz.

**Z. E. Lako:** Të këtij subjekti dhe ju jeni me autorizim.

**Z. N. Sulaj:** Po, e kam dorëzuar seancën e kaluar.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. E. Lako:** A ka ndonjë kërkesë për palë të interesuar në këtë proces?

**Z. Y. Merkaj:** Po, është Partia Socialiste, e cila ka paraqitur një kërkesë, ka edhe autorizimin. Andi Skënderaj dhe Maringlen Legisi janë përfaqësuesit e Partisë Socialiste.

**Z. E. Lako:** Për pjesëmarrjen në këtë proces keni të njëjtin argument si në proceset e tjera, që keni interes të ligjshëm.

**Z. M. Legisi:** Po, faleminderit, kryetar. I njëjti argument, nuk është se ka ndryshim.

**Z. E. Lako:** E kemi marrë këtë vendim në seancën...

**Z. M. Legisi:** Me sa di unë, te Kamza e kemi depozituar...

**Z. E. Lako:** Kështu që në qoftë se jeni përfshirë...

**Z. M. Legisi:** Jemi legjitimuar si palë e interesuar.

**Z. E. Lako:** Po, jemi legjitimuar si palë e interesuar, në rregull. Fillojmë me procesin. Ka ndonjë kërkesë paraprake për ndonjë konflikt interesit, a ndonjë gjë tjetër?

**Z. M. Legisi:** Jo, nuk kemi.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. F. Nuri:** Në lidhje me konfliktin e interesit, nuk kemi kërkesa paraprake. Ne do t'ju bëjmë një kërkesë, më mirë ta themi që tani në lidhje me vënien në dispozicion të kamerave. Kemi kërkuar vënien në dispozicion të kamerave, të nderuar, nga KQZ-ja. Na janë vënë në dispozicion vetëm një pjesë fare e vogël, rrëth 18 kamera të qendrave të votimit nga mbi 100 kamera dhe pjesa tjeter kandidati më thotë që i është vënë në dispozicion vetëm në orën 15.00.

**Z. E. Lako:** Mirë, kjo i përket themelit të çështjes dhe gjatë shqyrtimit mund ta kërkoni.

**Z. F. Nuri:** Kërkonim kohë për t'i shqyrtuar.

**Z. E. Lako:** Po në këtë fazë nuk kemi ndonjë kërkesë paraprake?

**Z. F. Nuri:** Jo paraprake, por do të kërkojmë kohë. Kjo ishte ideja.

**Z. E. Lako:** Mund të filloni, zoti Nuri, në lidhje me relatimin tuaj për sa i përket themelit të çështjes.

**Z. F. Nuri:** Faleminderit! Të nderuar, siç jeni në dijeni, ne kundërshtojmë me anë të këtij ankimi vendimin nr. 536, datë 20.5.2023 “Për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë dhe për këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Objekti i ankimit: kemi kërkuar ekspertim kompjuterik të çdo pajisje elektronike; krahasim të rezultatit elektronik të zgjedhjeve me rezultatin fizik; këqyrjen e kamerave të jashtme dhe ato të përdorura brenda qendrave të votimit;

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

krahasimin e kodeve të votuesve me listën e votuesve në çdo qendër votimi; rinumërim dhe rivlerësim të votave në të gjitha qendrat e votimit dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz dhe përsëritjen e zgjedhjeve edhe për kryetar bashkie, edhe për këshillin Bashkiak në Bashkinë Kamëz. Ne si koalicion dhe kandidati ynë, zoti Hoxha, pretendojmë se bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme se ka pasur parregullsi të shumta në lidhje me zgjedhjet në Bashkinë Kamëz. Për këto arsyen, vendimi i marrë nga Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 536, datë 20.5.2023 përmban elemente të paligjshme dhe jemi në kushtet kur ka prova, indicie, fakte të mjaftueshme, që flasin për problematika dhe për parregullsi të procesit zgjedhor. Për shembull, ka pasur probleme me pajisjet e votimit elektronik, pajisjet PEVN. Në mjaft raste janë denoncuar edhe publikisht edhe nëpërmjet medieve ku votohet kandidati i koalicionit tonë nga zgjedhësit dhe kemi dyshime që del e printuar me numrin rendor tjetër dhe vota i ka shkuar kandidatit rival. Për shembull, kemi rastin e qendrës së votimit nr. 1600, shkolla “100 vjetori” në Kamëz, ku është votuar për numrin rendor 3 dhe fleta e votimit është printuar me numrin rendor 1. Gjithashtu, ka edhe raste të tjera, ku ka pasur problematika të shumta në lidhje me vonesa të pashpjegueshme gjatë kohës së kryerjes së procesit të votimit elektronik nga pajisja PEN. Gjatë zgjedhjeve në ditën e votimit në këtë zonë zgjedhore ka pasur denoncime të panumërt nga votuesit për moskryerjen deri në fund të procesit të votimit, pasi pajisja nuk merrte komandën e dhënë te rubrika “Printo”. Ka pasur probleme të tillë, që kanë bërë të mundur që edhe një pjesë e votuesve të largohen dhe të mos e kryejnë procesin e votimit deri në fund. Një fakt tjetër i pakundërshtueshëm është ulja e numrit të votave për kandidatin tonë në mënyrë drastike, e pashpjegueshme kjo, dhe në mënyrë progresive për çdo qendër votimi në krahasim edhe me të gjitha proceset e votimit që janë kryer ndër vite në Kamzë e në Paskuqan. Këtu kemi edhe një tabelë

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

përbledhëse, të hartuar nga kandidati dhe stafi i tij, ku janë të renditura në mënyrë krahasuese të gjitha qendrat e votimit për Bashkinë Kamëz në vitet 2013, 2017, 2019, 2021 dhe 2023, ku rezultojnë diferenca drastike votash me ato të tabuluara gjatë këtyre zgjedhjeve, diferenca të cilat në total shkojnë në mbi 5300 vota vetëm në Kamëz, pa llogaritur Paskuqanin, dhe këto janë indicie që na shtyjnë të besojmë se ka pasur parregullsi dhe problematika në lidhje me këto zgjedhje. Gjithashtu, ka pasur probleme të mëdha dhe të theksuara me operatorët e caktuar në qendrat e votimit, të cilët duhet të ndihmonin zgjedhësit, kryesisht zgjedhësit që mund të kishin probleme ose vështirësi në kryerjen e votimit elektronik. Këto gjëra ne i kemi evidentuar dhe dosjen me provat paraprake do t'jua vëmë në dispozicion që sot, jo vetëm nëpërmjet fotografive, por edhe filmimeve të shkurtra, mund t'jua vëmë në dispozicion edhe në formë CD-je, dhe pse jo do të kërkonim në seancën vijuese, nëse do të ketë, këto të shihen edhe në monitor, ku ka raste të shumta, ku vetë personat që duhet të asistonin zgjedhësit afrohen dhe duken që ose i tregojnë si duhet të votojnë ose shtypin butonin e votimit te pajisja PEVN në vend të zgjedhësit, që janë shkelje flagrante. Gjithashtu, kemi evidentuar mjaft raste ku personi shoqëruesh ka shoqëruar disa zgjedhës, jo një zgjedhës të caktuar dhe në shumicën dërrmuese të rasteve pa autorizim përkatës. Pra, problematikat kanë qenë të shumta, pa hyrë tek pjesët e përdorimit të administratës, bizneset, përdorimin e patronazhitëve, që këto kanë qenë pothuajse në rang vendi problematika të theksuara. Ne nuk duam të zgjatemi, përderisa këtu kemi evidentuar edhe me një tabelë edhe punonjësit e administratës, me gjithë numrat përkatës të qendrave të votimit dhe pozicionit që kanë mbajtur, që kanë qenë prezentë në ditën e zgjedhjeve dhe në gjykimin tonë ka ndikuar dhe ka intimiduar zgjedhësit, por ajo që është e rëndësishme i kemi evidentuar edhe me fotografi përkatëse, që janë kryer ditën e votimit më 14 maj dhe këto janë indicie të mjaftueshme, ndërkohë ne kemi administruar një pjesë të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

kamerave, siç e theksuam edhe në fillim te ndërhyrja që bëmë, dhe nga ato elemente kanë dalë prova të mjaftueshme për t'u hapur e për t'u rinumëruar të gjitha kutitë e për t'u rivlerësuar të gjitha votat fillimisht, ndaj do të kërkonim nga KAS-i një kohë të mjaftueshme për të analizuar të gjitha kamerat e të gjitha qendrave të votimit, që fatkeqësisht na janë vënë në dispozicion vetëm përpëra pak minutash. Theksoj se suporti teknik që na është kërkuar nga KQZ-ja ne ua kemi vendosur në dispozicion administratës së KQZ-së që të shtunën dhe vetëm sot u bë e mundur kalimi i të gjitha videove, filmimeve, ndaj do të ishte e udhës të na vihej në dispozicion një afat kohor i arsyeshëm që t'i këqyrim të gjitha këto elemente dhe të bëjmë një hetim sa më të plotë e të thelluar të rastit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, zoti Nuri! Kandidati ka ndonjë gjë për të shtuar?

**Z. A. Hoxha:** Dy fjali, ju lutem. Meqenëse unë kam asistuar në një pjesë të këqyrjes së këtyre kamerave, theksoj faktin që në kundërshtim me procedurën, shumica e kamerave, besoj se është e qëllimshme, nuk fokuson komisionin, por vetëm pjesën e poshtme, pra, nuk arrin të fokusojë veprimet e komisionit. Do të duhen patjetër pamjet filmike që ne të evidentojmë shkeljet që ata kanë kryer gjatë gjithë ditës në mënyrë permanente nga operatorët dhe nga anëtarët e komisionit, prandaj në disa qendra votimi ose nuk na janë vënë në dispozicion, ose mënyra e pozicionimit të kamerave është e qëllimshme që nuk fokuson pjesën e dukshme të figurës së anëtarëve të komisionit, që është detyrim ligjor, por fokuson një pjesë që nuk mund të evidentojë disa shkelje. Megjithatë, ka qendra votimi që mbi 60%, 70% e votuesve është votuar nga operatori ose anëtari i komisionit me dorën e tij, që është shkelje flagrante, pra një pjesë e tyre nuk e kanë përfunduar vetë votimin, por votimin e ka

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

përfunduar operatori. Unë i kam me foto, por me pamjet filmike mendoj, duke vendosur një monitor, edhe ju do të krijoni bindjen tuaj që absolutisht në këto qendra votimi nuk ka pasur votim nga votuesit, por thjesht nga operatorët dhe anëtarët e komisionit. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Subjekti tjetër ankues, radha për ju.

**Z. R. Ramaj:** Po, i nderuar kryetar! Për Partinë Lëvizja e Legalitetit ne i qëndrojmë kërkesës që kemi paraqitur pranë KAS-it. Parimisht dhe ligjërisht mendojmë që kërkesa është e bazuar dhe duhet të pranohet. Duke qenë se ne kemi paraqitur pretendimet tona lidhur me mospërcjelljen në tabelën përbledhëse të rezultatit përfundimtar për anëtarë të këshillit bashkiak Kamëz të kandidatit të Partisë Lëvizja e Legalitetit, duke mos i dhënë mandatin përfundimisht për shkak të mospërfshirjes së dy qendrave të votimit, që janë QV-ja nr. 1575/00 dhe QV-ja nr. 1597/02. Mospërfshirja përfundimisht e këtyre dy QV-ve në tabelën përbledhëse përfundimtare ka sjellë në humbjen e mandatit të kandidatit të Partisë Lëvizja e Legalitetit. Në procesverbalet që ne kemi marrë me foto nga komisioni, i cili ka bërë edhe tabelën përbledhëse të rezultatit, thuhet që për shkak të një gabimi, për shkak të mosfunkcionimit të kodit 5 në këto pajisje elektronike, gjatë votimit elektronik dhe numërimit elektronik këto dy QV nuk janë të përfshira në rezultatin përfundimtar. E para, doja t'ju bëja me dije, ju anëtarëve të nderuar, duke qenë se është një rezultat dhe votim elektronik i futur si risi për të dyja rastet, në ditën e parë, pas daljes së rezultatit paraprak, edhe në faqen e KQZ-së janë publikuar votat përkatëse, janë 1008 vota për kandidatin e Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe në ditën e nesërme, datë 16, e më pas në datën 17 deri në datën 19 rezultati qëndron midis

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 8

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

votave 1008 dhe 996, duke e pasur fitues kandidatin e Partisë Lëvizja e Legalitetit. Në momentin e fundit, pra në datën 19, pas 5 ditësh, ndryshon tabela përbledhëse dhe përjashtohen këto dy QV për shkak të këtij gabimi, siç është thënë, ose për shkak të mungesës së këtij kodi, duke mos u përfshirë në rezultat. E para është deformuar vullneti i zgjedhësve, sepse në ato dy QV nuk bëhet fjalë vetëm për votues të Partisë Lëvizja e Legalitetit, por mund të jenë mbi 500 votues që kanë hedhur votën rregullisht. Makineria ndryshe nga njerëzit e ka reflektuar rezultatin në kohë dhe drejt dhe më pas është ndryshuar nëpërmjet një vendimi të disa individëve, persona zyrtarë që kanë parë e kanë vepruar mbi këto dy QV. Në këto kushte, ne mendojmë, duke parë të gjithë situatën dhe rezultatin që është reflektuar në rezultatet paraprake në faqen e KQZ-së, por duke parë që është deformuar edhe një numër i madh votash, mund të jenë mbi 500 vota në këto dy kuti, që ky rezultat duhet të ishte reflektuar bashkë me këto dy qendra votimi, sepse procesi aty, në këndvështrimin tonë, është i drejtë dhe i ndershëm, sepse vetë pajisjet dhe rezultati paraprak ka dalë i rregullt. Për këto arsyе ne kemi kërkuar edhe hetim të thelluar në mënyrë që të verifikohet nëse ka probleme, ka mangësi. Mund të kishte shumë mënyra për të verifikuar sesi është votuar dhe si është numëruar, pra, a ka pasur probleme me numrin e votuesve në total, a ka pasur probleme me mënyrën sesi kanë funksionuar pajisjet. Këto gjëra nuk reflekton në procesverbal, por thuhet që ka vetëm një problem me kodin 5 dhe është hequr përfundimisht nga tabela përbledhëse. Në këtë këndvështrim, ne mendojmë që kërkesa jonë është e bazuar në ligj dhe duhet pranuar nga ana juaj, në mënyrë që të kemi, siç e thashë, një rezultat sa më të drejtë e të vlerësohet më drejt vota e qytetarëve. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 9

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Për palën e interesuar Partia Socialiste në këtë fazë keni ndonjë prapësim në lidhje me çfarë kërkohet? Kandidati i Partisë Lëvizja e Legalitetit.

**Z. N. Sulaj:** Të nderuar anëtarë të KAS-it, siç jeni në dijeni, në Bashkinë Kamëz zgjedhjet për pushtetin vendor janë zhvilluar në mënyrë elektronike. Në këtë proces zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit ka qenë e regjistruar dhe ka konkurruar me listën e saj vetëm për anëtarë të këshillit bashkiak. Në këtë proces zgjedhor PLL-ja nuk ka pasur asnjë përfaqësues në administrimin e procesit zgjedhor, qoftë komisioner, qoftë vëzhgues, pasi kishim besim se me votimin dhe numërimin elektronik nuk do kishte deformim të votës, por në fund të procesit na rezultoi e kundërta. Garanci për këtë proces zgjedhor kishte dhënë publikisht edhe Komisioneri, zoti Celibashi, i cili pati deklaruar publikisht në një medie se rezultati në bashkitë me votim elektronik do të shpalloj 30 minuta pas mbylljes së procesit zgjedhor, gjë e cila nuk na rezultoi e saktë. Në pritje të rezultatit përfundimtar, duke ndjekur nga faqja publike e KQZ-së në datën 15.5.2023, ora 3.15 minuta na rezultoi se ishin numëruar 133 qendra votimi nga 133 që kishte në total Bashkia Kamëz dhe rezultati i PLL-së ishte 1008 vota, rezultat i cili na jepte një mandat përfaqësimi për PLL-në në këshillin bashkiak Kamëz, rezultat i ruajtur ky edhe me *screenshot* nga ana jonë në faqen zyrtare të KQZ-së. Në datën 15.5.2023, ora 23.00 vërejmë se në faqen publike të KQZ-së rezulton se PLL-ja kishte 999 vota. Ky rezultat ngriti dyshime të mëdha te ne. Duke e parë në mënyrë të detajuar faqen publike të KQZ-së, na rezulton se ishte zeruar qendra e votimit nr.1568/00...

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. E. Lako:** Ju lutem, zoti kandidat, këto i keni shkruar në ankim, u referuan edhe nga avokati juaj. Nëse keni gjë tjetër, se këto i kemi të shkruara, i dimë, i kemi parë. Nëse ju keni diçka për të shtuar, që të mos rrimë e t'i përsërisim prapë.

**Z. N. Sulaj:** Po, të nderuar zotërinj, kërkoj hetimin e të gjithë veprimtarisë së personave të ngarkuar me detyrë si komisionerë, anëtarë, sekretarë, nënkyetarë, kryetarë në dy qendrat e votimit, qendrën nr. 1575 dhe nr. 1597/2, a kanë vepruar në përputhje me detyrimet ligjore që përcakton Kodi Zgjedhor. Hetimin e të gjithë veprimtarisë së personave të ngarkuar me detyrë si komisionerë, anëtarë, sekretarë, nënkyetarë, kryetarë të KZAZ-së nr. 27 Kamëz, pasi nuk kanë vepruar në përputhje me detyrimet ligjore që u përcakton Kodi Zgjedhor, sipas mendimit tonë. Kërkojmë pavlefshmërinë e vendimit nr. 15, datë 16.5.2023, ora 16.00, pasi për ne si palë ankuese është në papajtueshmëri me nenin 115 të Kodit Zgjedhor. Hetimin e të gjithë veprimtarisë së personave përgjegjës në KQZ, të cilët me veprimet ose mosveprimet e tyre kanë sjellë këtë situatë të papranueshme, si: veprimet e tyre a kanë qenë në përputhje me nenet që përcakton Kodi Zgjedhor dhe të shohim ankesën e bërë nga ana jonë në datën 16.5.2023 paradite. Cilat ishin veprimet e KQZ-së dhe nenet e Kodit? Të nderuar zotërinj, kërkojmë hetim të thelluar dhe të detajuar për të gjithë procesin zgjedhor elektronik në dy qendrat Kamëz, përkatësisht në dy qendrat e votimit: 1575 dhe 1597/2, si edhe përgjigje për disa pyetjet të adresuara nga ana jonë nëse mund t'i bëjmë. A ishin të certifikuara dhe kolauduara këto pajisje elektronike?

**Z. E. Lako:** Do të kalojmë pak më vonë te pjesa e pyetjeve dhe ju mund t'i bëni këto pyetje. Faleminderit! Palët e interesuara.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. A. Skënderi:** Faleminderit! Fillimisht dua të sqarojmë faktin që ne jemi këtu vetëm për pjesën e ankimit sa i përkon “Bashkë Fitojmë” dhe jo për Lëvizjen e Legalitetit, apo për vendimet që solle tani para nesh. Sa i përket pretendimit që sjell koalicioni “Bashkë Fitojmë”, vendimi numër 536, të cilin këta kundërshtojnë, mendoj se nuk qëndron për arsy se në themel të këtyre kërkimeve që ata kanë sjellë në objektin e kërkimit përballë komisionit vlerësohet se shkeljet e konstatuara, sipas tyre, do të sjellin edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën elektorale të Kamzës ku ato mendojnë se janë bërë këto padrejtësi. Në materialin që kanë referuar, si ankim dhe na është depozituar ne, nuk ka pasur mjaftueshëm prova dhe fakte të provueshme për pretendimin që ata kanë sjellë. Megjithatë edhe nga leximi i Kodit Zgjedhor, kryesisht nen 160 i tij, duhet pasur parasysh se rastet e pavlefshmërisë së zgjedhjes lidhen kryesisht në rastin konkret, objekt kërkimi përballë komisionit dhe në lidhje me pikën 1 të tij, që lidhet me kërkuesat e subjektit zgjedhor dhe kushtet e kriteret që mund të shallen ato të pavlefshme, të cilat i ka pikëzuar në rend kronologjik, duke filluar nga shkronja “a”, “b”, “c” dhe në vijim. Konkretnisht duke referuar të gjithë materialin e dorëzuar, ndalet kryesisht te fakti i shkronjës “a” që lidhet me shkeljet e ligjit ose që kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor siç pretendohet edhe sot në këtë komision, të ndodhura në qendrat e votimit të cilat mund ta kenë çuar procesin zgjedhor në ndikim të mandateve ose në zonat zgjedhore përkatëse. Duke pasur parasysh edhe nenin 161 të Kodit Zgjedhor, në lidhje me përsëritjen e zgjedhjeve, siç do të pretendohet në përfundim, në lidhje me ndarjen e mandateve dhe aktet që ata sjellin në këtë proces, në lidhje me këto pretendime të tyre, mendojmë që në kuptim të nenit 160 shkronja “a” të Kodit Zgjedhor nuk plotësohen kushtet kumulative që kërkon dispozita për sa i takon faktit të shkeljeve të ndodhura përvijueshmërisë së faktit të ndodhur dhe sidomos atë që Kodi Zgjedhor e ka saktësuar në mënyrë të posaçme faktin e dëmtimit të rëndë të procesit zgjedhor dhe

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

shkeljet e këtij niveli. Kështu që, duke marrë në konsideratë, për të mos u zgjatur, sepse e kam sjellë më shkrim diskutimin përmë gjatë duke u ndalur në të gjitha pikat që koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka paraqitur para jush duke pasur parasysh këtë dispozitë ndaluese dhe fakti që objekti i ankesës lidhet pikërisht me përsëritjen e këtyre zgjedhjeve dhe mosplotësimin e kritereve kumulative që njeh dispozita në rastin: objekt shqyrtimi, mendoj se nuk ka kushte përtu marrë parasysh nga ana juaj në kuptimin ligjor përaq sa rregullon Kodi Zgjedhor sa i përket këtyre dispozitave, kështu që në këto kushte mendoj që materiali i depozituar dhe ankimi nuk ka vlerë për procesin dhe mendoj që të rrëzohet kërkesa duke u lënë në fuqi vendimmarja e mëhershme në lidhje me zonën e Kamzës. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit, siç e theksuat pra ju keni koment vetëm përpjesën ankimit të koalicionit. Për ankuesin tjetër nuk keni ndonjë gjë?

**Z. A. Skënderi:** Jo nuk kemi.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Atëherë, zoti Merkaj do t'ju lutesha të na bëni një përbledhje të asaj çfarë do të thotë administrata e KQZ-së në lidhje edhe me pretendimet që dëgjuam përtë dyja palët, po i rendis unë këtu pak shkurtimisht: në lidhje me pretendimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” në lidhje me përdorimin e votimit elektronik të pajisjeve të votimit elektronik, cicarë u tha, meqë është edhe për herë të parë në këtë bashki, dhe janë këto pretendimet që ishte një provë që ne nuk e kemi parë ende, por që është shtypur njëshi, numri 1 dhe ka dalë numri 3, a mund të ndodhë kjo? Dhe ku është e mbështetur? Ka te pretendimet një kërkesë tjetër që ndryshe ka dalë numri i votuesve përkëshill bashkiak dhe ndryshe ka dalë numri i votuesve përkryetar bashkie, çfarë kemi parë në ankim, përderi sa nuk kemi

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023**

të bëjmë me gabim njerëzor, sepse është pjesë që e nxjerr pajisja elektronike, pra në lidhje me këto pretendime do të donim mbase edhe ndonjë mendim eksperti nga ana e KQZ-së për sa i përket si i bëhet ky proces dhe sa mundësi ka që ndryshe të shprehet vullneti dhe ndryshe të dalë rezultati nga çfarë dëgjuam, pavarësisht se nuk janë dorëzuar ende provat nga ana e ankuesit. Gjithashtu, edhe për pjesën tjeter të animit, cila është arsyja që këto dy QV, nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtar, dhe janë pasqyruar në procesverbalet përkatëse, për arsyen se edhe këtu ne nuk kemi ndonjë material apo provë, ose fakt të dorëzuar edhe nga ankuesit që janë pasqyruar këto në librin e protokollit? Cili është shkaku dhe pse kërkohet që këto të merren parasysh nga KAS-i në përfshirjen e rezultatit përfundimtar?

Faleminderit!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit, zoti Lako! Për dy pyetjet e para është thirrur sot në mbledhje drejtori i IT-së i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili është më kompetent për t’iu përgjigjur pyetjes që programimi paraprak i pajisjes, dhe pyetja e dytë që kishte të bënte me rezultatin paraprak dhe ndryshimin me rezultatin përfundimtar. Kështu që do të flasë zonja Daniela.

**Z. D. Aliahmeti:** Përshendetje të gjithëve! Unë do të jap dy sqarime në lidhje me ndërtimin e arkitekturës dhe funksionimin e pajisjes PEVN. Pajisja në vetvete është ndërtuar si një pajisje *stand alone* e vendosur në çdo QV, dhe një sistem qendror i cili ndodhet në Lundë. Duhet të kemi parasysh se sistemi funksionon, ose pajisja funksionon *stand alone* gjatë të gjithë procesit, nga hapja e votimit në orën 7:00 deri në mbylljen e tij në orën 7:00 pasdite. Pajisja nuk ka të vendosur asnjë pjesë transmetimi *wi-fi*, ose elemente të tjera që kalojnë informacionin. Kjo do të thotë informacioni është i ruajtur në pajisjet PEVN dhe transmetimi i këtyre të dhënavë

*Zbardhi materialin audio*  
*Alma KOLA*

 14

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

në sistemin qendror bëhet vetëm në fund pasi mbylljet procesi dhe pasi në kutinë e votimit, në kutinë shoqëruese të makinës, printohen rezultat jo paraprake, por rezultatet e asaj qendre votimi. Kjo do të thotë kemi mundësinë të verifikojmë se cili ka qenë rezultati në atë kuti, pa u transmetuar informacioni dhe pa u agreguar i gjithi në sistemin qendror të KQZ-së. Një element që u tha ishte zgjedhja e një alternative dhe printimi i një alternative tjeter, e cila nuk është e mundur. Ne iu kemi bërë ftesë të tëra partive nëpërmjet dy shkresave edhe për demonstrimin, edhe për demonstrimin e pajisjes së votimit shkresa me numër 3872 të datës 17 prill, gjithashtu edhe një shkresë tjeter për testimin operacional. Në testimin operacional ne tregonim funksionimin e të gjithë pajisjes dhe të gjithë sistemit dhe për partitë politike. Në këtë testim operacional janë parashikuar ose janë marrë një numër prej 3% të pajisjeve që detyron Kodi Zgjedhor dhe është testuar i gjithë procesi, do të thotë i gjithë procesi nga fillimi, nga votimi i çdo votuesi të improvizuar gjatë testimit, deri te rezultati përfundimtar, printimi i raporteve dhe verifikimi ose krahasimi i këtyre të dhënave me ato çfarë transmetohet ose çfarë kishim të vendosur në server. Këto janë lehtësisht të evidentueshme. Një element tjeter që dua të sjell në vëmendje është që *software*-i ka qenë, është i njëjtë për të tëra pajisjet kudo në të tëra qendrat e votimit dhe, nëse do të kishim një problematikë në *software*-in do të ishte do të dukej ose do të shfaqej do të kishim reklamim të gjësë në të tëra qendrat e votimit dhe jo vetëm në Kamzë. Soft-i është i njëjtë që është përdorur dhe për Elbasanin, edhe për Kamzën, edhe për Vorën. Kjo do të thotë se për të tri bashkitë është përdorur i njëjtë aplikacion, i cili është testuar paraprakisht. Që do të thotë se ne kemi informacion dhe kemi rezultate të ardhura, dhe kemi vlerësim të të gjithë procesit nga fillimi deri në fund. Gjithashtu, për të sqaruar më tej ideja është që mund të verifikojmë se çfarë ka në kutitë shoqëruese ama edhe pjesa e transmetimit në vetvete, sistemi qendror dhe transmetimi i të dhënave është

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 15

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

i enkriptuar, në mënyrë të tillë që mundëson, le të themi, edhe evidentimin se nga ka ardhur ky informacion, do të thotë se cila kuti e ka dërguar informacionin në sistemin qendror, gjithashtu, ka të enkriptuar edhe informacionin brenda kutisë, ose informacionin brenda të dhënavë që transmetohen në sistem. E thënë kjo e bën të paverifikueshme dhe nuk është e mundur teknikisht që të zgjidhet një alternativë dhe të printohet një alternativë tjeter. Mund të testojmë ose mund të provojmë, ne kemi pajisje, të cilat janë prodhuar, janë të programuar për WATI-n testin operacional , të cilat mund t'jua vë në dispozicion zotërinjve që t'i shohin t'i vlerësojnë vetë, atë që nuk e bënë gjatë testit operacion, kur është bërë ftesa, mund ta bëjnë tani dhe të shohin se si funksion në të vërtetë pajisja. Kjo ishte për pjesën e pyetjes së parë, do të thotë për ndryshimin a ka mundësi të tilla. Pra, teknikisht kjo gjë nuk është e mundur. Dua t'ju sqaroj edhe një gjë tjeter, zotërinj, “*Smart Matik*”-u është kompania që ofron shërbimin dhe duke vendosur ose duke bërë këtë unë jam teknik, por në *common sense* kompania ofron shërbimin, por këtë shërbime ofron jo vetëm për Shqipërinë, por këtë pajisje dhe shërbime i ofron edhe për vende të tjera dhe në vendet e Europës. Është një kompani e mirënjohur, e cila në fund të ditës ka për qëllim që kostot e veta të jenë, ose përfitimet të mbulojnë kostot, e thënë ndryshe. Dhe është kompanie cila, po marr dy shembuj, edhe Belgjika, edhe Bullgaria përdor të njëjtën kompani për shërbimin e zgjedhjeve. Belgjika ka një sistem goxha të komplikuar të zgjedhjeve. Në lidhje me tabelat përfundimtare të rezultateve, të cilat patën një ndryshim midis vlerës në një kuti për kryetar dhe për këshill. Dua të sqaroj një proces. Gjatë momentit të hedhjes, gjatë transmetimit të të dhënavë, sistemi ka rritur të marrë pjesën më të madhe të informacionit, por, duke qenë se ishin tri bashki dhe është në sistem pilotimi, ne kishim ndërkohë edhe sistemin tonë në të cilin hidhnik manualisht të dhënat të merreshin nga operatorët. Kjo do të thotë futet elementi i gabimit manual, gabimit njerëzor gjatë hedhjes së të dhënavë në

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



16

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

momentin kur bëhet rakordimi i të gjitha të dhënave për të pasur rezultatin paraprak. Do të thotë kjo është bërë nga KQZ-ja, në momentin që kemi pasur rezultatet e Kamzës, të Elbasanit dhe të Vorës, janë krahasuar ose janë parë informacionet, nga nuk iu është marrë informacioni dhe është hedhur dhe ky informacion ose mund të ketë pasur gabime manuale nga operatorët, në rritje ose në zbritje, të votave. Kjo, procesi manual dhe procesi automatik në një moment bashkohen bashkë me njerëzit dhe kjo ka sjellë problematikën që evidentuan zotërinjtë më përpara. Unë e jam e hapur për çdo pyetje nëse keni ndonjë gjë për pjesën e sistemit.

**Z. E. Lako:** Do të kalojmë patjetër te pyetjet, por të mbarojmë me relatimin e sekretarit të Përgjithshëm, por unë desha të kishim të qarta disa piketa mbi të cilat pastaj mund të vazhdojnë dhe palët të bëjnë pyetjet e tyre. Po, zoti Merkaj.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dy qendrat e votimit pse ka ndryshuar rezultati dhe ku nuk janë përfshirë?

**Z. Y. Merkaj:** Do të përgjigjem unë për këto pyetje. Komisioni Rregulator në datën 13 prill 2023 ka marrë një vendim ku janë miratuar rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektrik me anë të pajisjes PEVN, për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në bazë dhe zbatim të këtij vendimi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin numër 415, datë 26.04.2023 ku ka përcaktuar rregullat procedurale teknike për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisej elektronike të votimit dhe numërimit elektronik, në QV-të Bashkia e Elbasanit, Kamzë dhe Vorë. Në bazë të këtij vendimi janë dhy shtojca, shtojca numër 2 është që bën fjalë për pjesën e dytë që është numërimi i votave. Ne pikën 5/c parashikohet rasti kur një kuti votim ose një qendër votimi mund të shpallet e parregullt. Kjo i është referuar nenit 115 të Kodit Zgjedhor ku

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

citoj pikën 7 të kësaj lidhjeje që thotë: “PEVN-të dhe kutitë shoqëruese të votimit të përcaktuara si kuti të parregullta në asnjë rast dhe për asnjë arsyе nuk mund të futen në procesin e nxjerrjes së rezultatit nga KZAZ-ja. Këto PEVN dhe kuti dërgohen në KQZ, së bashku me kutitë e materialeve të votimit për nevoja të hetimit administrativ”. Nga këqyrja e librit të protokollit të KZAZ-së konstatojmë që këto dy kuti janë shpallur të parregullta nga grupi i marrjes në dorëzim. Nëse më lejoni mund të lexoj pjesë nga libri i protokollit, ku thuhet: “Procesi i përpunimit të dhënave të PEVN-së nga operatorët filloj sipas renditjes rastësore të pajisjeve të renditura në sallë. U bë përpunimi i 89 qendrave të pajisjeve PEVN, nga qendra 1564/00 deri në qendrën e votimit 1601/00. Gjatë përpunimit të këtyre të dhënave të rezultateve të tabelave përbledhëse si dhe për kryetarin e bashkisë dhe për këshillin e bashkisë janë hedhur edhe dy qendra votimi me numër 1575/00 dhe një me numër 1597/02, të cilat ishin konstatuar nga grupi i punës si qendra të parregullta, pasi iu mungonte kodi i sigurisë, kodi i 5-të i mbylljes së dritares së printerit. Gjatë transferimit të dhënave nga *usb*-të të gjitha qendrave të votimit të KZAZ-së numër 27, gabimisht janë përfshirë në rezultat edhe këto dy qendra votimi: 1575/00 dhe 1597/02, të cilat ishin vlerësuar si të parregullta. Për këtë arsyë komisioni zonal i administrimit zgjedhor, numri 27, miratoi tabelën përbledhëse të rezultatit në korrigimet e cituara më lart pa përfshirë në të rezultatet e dy qendrave të votimit 1575/00 dhe 1597/02. Pra, miratoi rezultatin përfundimtar për 87 qendra votimi”.

**Z. E. Lako:** Janë përfshirë njëherë doni të thoni dhe pastaj janë hequr, por nuk i kanë konstatuar në momentin e dorëzimit?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** I kanë konstatuar grupi i marrjes në dorëzim, por nuk e di tani, ngaqë ka qenë me votimin për herë të parë votimi elektronik janë ngatërruar dhe pastaj kur kanë hedhur qendrat e votimit janë parë.

**Z. E. Lako:** Por kjo QV-ja mund të jetë edhe për palën meqë jemi këtu 1586, që është referuar në fillim çfarë lidhjeje ka me këto dy QV-të? Se ju tek ankimi flisni që ka qenë edhe QV-ja 1568, ishte zëruar rezultati, pastaj dalin këto dy QV-të e tjera.

**Përfaqësuesi i PL:** Tek ajo qendër ditën e parë ishte zëruar ajo qendër dhe nuk kemi marrë asnjë informacion nga KQZ-ja, dhe pastaj është rregulluar rezultati dhe ka dalë edhe rezultati i asaj qendre votimi, pastaj janë zeruar edhe dy të tjera dhe kjo ngjan, të themi të drejtën, si shumë qesharake, 01 pastaj 02 të tjera.

**Z. E. Lako:** A ka ndonjë koment për këtë, zoti Merkaj?

**Z. Y. Merkaj:** Te tabela përbledhëse e rezultatit 1568/00 është miratuar tabela dhe Partia Lëvizja e Legalitetit ka marrë 9 vota. Tani flasim për rezultat paraprak dhe rezultat përfundimtar normalisht që mund të ketë pasur lëvizje.

**Z. E. Lako:** Mund të ketë pasur lëvizje për shkak të asaj që sqaruat dhe më parë. Për pretendimet e palës tjetër, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, a keni ndonjë koment për ankimin? Për pjesën e provave?

**Z. Y. Merkaj:** Janë më shumë teknikë, nuk e di programimi i pajisjes....

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. E. Lako:** Për provat, u pretendua se provat nuk janë marrë ende sepse është janë kthyer përgjigjet me vonesë dhe nuk kanë mundur dot që...

(Diskutime pa mikrofon)

Janë marrë dhe janë dhënë me vonesë, dhe shkaku ka qenë?

**Z. Y. Merkaj:** Janë marrë me vonesë. Koha e gjatë.

**Z. D. Aliahmeti:** Janë rreth 133 qendra votimi, të cilat filmimet shkojnë rreth 20 giga për qendër votimi dhe kapaciteti për t'u përpunuar dhe për t'u marrë dhe për t'u kaluar është goxha i lartë.

**Z. E. Lako:** Pra, tani ata i kanë marrë të gjitha materialet e kërkura.

**Z. Y. Merkaj:** Ideja është që nga administrata e KQZ-së është bërë përpjekja maksimale, koha më e shkurtër e mundshme.

**Z. E. Lako:** Dakord. Kalojmë te zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Do të kthehem prapë te historia e kutive që janë deklaruar të parregullta. Unë kam përshtypjen që ne kemi nevojë të kuptojmë se ku qëndron parregullsia. Fakti që thuhet mungonte kodi i pestë te kutia që printon votat, çfarë do të thotë? Si e cenon kjo votimin?

**Znj. D. Alimemeti:** Siç e përmendi zoti sekretar më përpara, është miratuar një procedurë nga Komisioneri, le të themi, në lidhje me përpunimin teknik të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

informacionit. Që kutia të quhej e rregullt duhej të kishte 4 vlat shoqëruese, le të themi. Kutia shoqëruese duhet të kishte 4 vlat e sigurisë së bashku me vulën e 5-të, e cila kur hiqet printeri nga kutia bllokoni, nuk jep mundësi të futet ose të hedhë informacione të tjera, ose fletë të tjera votimi, po supozojmë, dhe duhet të mbyllët dhe ajo. Në këtë moment kjo kuti quhet e rregullt. Mungesa e kodit të sigurisë për printerin ose një numër tjetër i kodeve të sigurisë e bënte kutinë të parregullt. Besoj ky është sqarimi që kërkonit, që do të thotë mungon mbyllja e kutisë së printerit dhe e bën të aksesueshme, e hap dhe e mbyll kutinë lehtësisht.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, në qoftë se hiqet printeri aty krijohet një zgavër dhe po u krijua zgavër mund të futet dora, dhe të merren e të nxirren fletët e votimit, dhe eventualisht mund të printohen fletë votimi më mbrapa me të njëjtën printer dhe të futen aty brenda. Mund të ndodhë kjo?

**Znj. D. Alimemeti:** Me të njëtin printer jo, mund të hiqen vetëm në sasi numërimi, sepse printeri duhet të lidhet me pajisjen. Nuk bëhet, domethënë nuk ndodh.

**Z. I. Rusmali:** Po, por duke pas në KQV pajisjen dhe printerin, mund ta bësh mbrapa, pas votimit.

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, sepse votimi quhet i mbyllur.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë që kur deklarohet votimi i mbyllur, pajisja mbyll procesin dhe nuk funksionon më.

**Znj. D. Alimemeti:** Pajisja mbyll procesin automatikisht dhe nuk funksionon më.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. I. Rusmali:** Opsioni që ekziston është vetëm më pak fletë votimi, më pak fletë votimi nga ajo distina.

**Znj. D. Alimemeti:** Nga çfarë ka deklaruar sistemi në vete.

**Z. Y. Merkaj:** Se fletët e votimit janë të vogla, si kupon, nuk janë fletë votimi normale.

**Z. L. Braho:** Nga të gjithë këto qendrat e votimit, ku janë përdorur këto pajisjet elektronike, janë hapur kutitë e printerëve, është bërë ndonjë verifikim në rastet e qendrave të tjera? Pra, nuk është hapur asnjë kuti dhe rezultati del nga pajisja elektronike pavarësisht printerit.

**Znj. D. Alimemeti:** Po, nuk ka lidhje.

**Z. L. Braho:** Fakti që mungon kjo vula e pestë e cenon rezultatin pajisja elektronike?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, vetëm verifikimi në letër ajo çfarë thamë, le të themi, siguria.

**Z. L. Braho:** Pra, rezultati i pajisjes dihet dhe në qoftë se ne bëjmë një konfirmim dhe numri i fletëve në printer është i barabartë me atë që ka pajisja, i bie që është e saktë.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. L. Braho:** Kisha edhe një pyetje tjetër: po në qoftë se këto kutitë kanë qenë të parregullta, Ylli, pse janë hedhur në fillim, sepse ne kemi pasur edhe raste të tjera kutish të parregullta këtu dhe nuk janë hedhur fare.

**Z. Y. Merkaj:** Tani ideja është që në KZAZ është krijuar një eksperiencë që nga viti 2005, që është bërë numërimi i përqendruar dhe KZAZ-të kanë fituar një eksperiencë dhe që në momentin që i marrin në dorëzim, i vendosin te një vend i caktuar. Duke qenë se ka qenë votimi elektronik, si herë e parë ndoshta KZAZ-të janë ngatërruar.

**Z. E. Çefa:** Unë kam një pyetje prapë për zonjën. Nuk e di ndoshta mbasi nuk e kuptova unë mirë, por ju iu referuat në fillim disa gabimeve në rezultatet paraprake si gabime njerëzore të hedhjes së rezultateve. Tani në rastin e Kamzës të 2 kutive, ka ndodh ky fenomen, apo jo?

**Znj. D. Alimemeti:** Kur janë evidentuar që 2 kutitë kanë qenë të parregullta, do të thotë është evidentuar që ne vetëm i kemi shpallur këto kuti nga sistemi të pavlefshme. Domethënë kanë qenë vota të hedhura dhe ne i kemi çaktivizuar, në njëfarë mënyrë, si kuti dhe ato vota janë zbritur nga totali.

**Z. E. Çefa:** Pra, që ta formuloj ndryshe, kandidati dhe ankimesi pretendojnë që ishin 1008 vota në tabelën paraprake të publikuar nga KQZ-ja, në një moment të caktuar. Tani këto 1008, të cilat, prapë sipas pretendimit të kandidatit, në një moment janë bërë 900 e diçka e pastaj janë ulur edhe më tepër, pra 1008-ta është e saktë, apo është pasojë e gabimit njerëzor?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk mund ta them këtë, domethënë duhet t'i referohemi, duhet të shohim pak kronologjinë. Nuk mund ta them tanë këtë moment në qoftë se është kjo shifra e saktë, por mund të them që në momentin që janë evidentuar që këto 2 kuti kanë qenë të parregullta nga sistemi i përgjithshëm jo nga ai, kanë zbritur direkt. Do të thotë që pavarësisht se çfarë rezultati kemi pasur.

**Z. E. Çafa:** Pra janë zbritur nga 1008-ta apo nga ndonjë shifër tjetër? Këtë desha të di.

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk jua them dot.

**Z. E. Çafa:** Dakord, faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Procedura siç e kuptova unë nga shpjegimet tuaja, parashikon që me mbylljen e votimit, anëtarët e komisionit marrin *print out* nga kutia, marrin kuponin me rezultatin e zgjedhjeve, pa bërë asnjë veprim tjetër, pa transportuar kutitë aty ku janë, se çdo anëtar i Komisionit merr printimin e rezultatit të zgjedhjeve dhe e fut në xhep. Kjo gjë ka ndodhur pa modifikuar kutinë, pa mbyllur gjë, pa bërë veprime, do të thotë që ky rezultati i *print out*-it është i njëjtë me rezultatin që keni publikuar ju?

**Znj. D. Alimemeti:** Është e njëjta përgjigje. Në këtë moment unë nuk di t'i referohem, por besoj që po, do të jetë i njëjti rezultat që është hedhur në sistem dhe pastaj le të themi është zerraar. Të dhënët, dua t'ju sqaroj vetëm një element: është marrë pasi është transmetuar informacioni në KQZ, le të themi. Kemi patur dhe verifikimet pati *print out-it*, që ju thoni, duke e parë ose duke përcaktuar se cilat QV kanë patur mungesa ose problematika gjatë transmetimit që jemi përpjekur që këtë

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

informacion ta hedhim, sepse ka qenë rezultat paraprak, në sistem manualisht. Nuk di t'ju them në qoftë se këto 2 QV kanë pasur problematika të tilla, ama procedura është kjo: që është ndjekur procesi i hedhjes automatiqe, është shoqëruar më një proces manual, i cili mund të këtë sjellë problematika të tilla në pjesën e lëvizjes të numrave, por në fund fare është bërë rakordimi midis 2 të dhënave tona.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, nga momenti i sotëm kemi mundësi ta verifikojmë ne këtë fakt? Kemi mundësi të kontrollojmë me KQV-në *print out*-in, me rezultatin tuaj elektronik? Ju si subjekt e keni rezultatin e *print out* -it?

**Z. A. Hoxha:** Jo, nuk e kemi, i nderuar, kemi vetëm foto të *screenshot*-it të rezultatit paraprak.

**Z. I. Rusmali:** Jo, nuk na ndihmon, sepse është domethënë informacion i derivuar, nuk është informacion origjinal.

**Znj. D. Alimemeti:** Do të bëjmë vlerësimet dhe do të shohim kronologjinë e tërë informacionit që ne kemi nga operatorët. Këtë informacion e kemi marrë nga operatorët në momentin e parë të transmetimit.

**Z. E. Lako:** Meqë edhe ju jeni këtu, një sqarim në lidhje me pretendimet të palës ankuese të koalicionit “Bashkë Fitojmë” në lidhje më vonesat në procesin e votimit elektronik apo të operatorëve që kanë ndihmuar votuesit, më shumë se 1., pa procedurë. Mund të na sqaroni në lidhje mes këtyre pretendimeve se çfarë ka ndodhur dhe si qëndron?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Znj. D. Aliahmeti:** Vonesat në PVN, mund të ketë qenë një pajisje, që nuk besoj se ka pasur vonesa ndryshe nga pjesa tjetër e sistemit.

**Z. I. Rusmali:** Më fal, që po të ndërhyj, pretendimi është shtyp 3 –shin, vonohet procesi, po të shtypësh 1 –shin, ecën shpejt?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, nuk qëndron, jo është e njëjta.

**Z. E. Lako:** Keni pyetje?

**Z. A. Hoxha:** Unë rezervoj të drejtën t'ju informoj që nuk jam ekspert IT-je, jam marrë shumë vite, siç ju informova edhe në seancën e kaluar, me hetimin e krimeve kibernetike, atë punë kam patur. Unë dua ta pyes drejtoreshën, siç e kemi bërë edhe në kërkesë: a mund ajo pajisje parapake, sepse në dijeninë time është implementuar edhe në Maqedoni jo vetëm në Bullgari dhe në Belgjikë, por edhe në Maqedoni, pjesërisht ka problematika të theksuara edhe në Maqedoni, nuk jam ekspert i fushës, u kërkoj të nderuarve që në seancën e radhës të vijë një ekspert të asistojë për të bërë oponencën. Nuk jam i aftë për të bërë oponencën tuaj aspak, por një pyetje kisha: ju na thatë këtu që mund të marrim një pajisje test dhe ta testojmë. Ajo nuk tregon asgjë, sepse ajo pajisja test mund të jetë vërtet e saktë, akoma nuk jemi informuar nëse është e njëjta firmë që ka sjellë pajisjet, e njëjta firmë që ka bërë magazinimin dhe sigurimin e tyre dhe e njëjta firmë e cila i implementon ato pastaj në terren. Dhe tjetra a mundet që këto pajisje, secila prej tyre, sepse ju thatë në fund ato lidhen me *network* që transmetojnë të dhënat në serverin kryesor të çdo QV-je të serverit të pavarur, ose mënyrë tjetër të transmetimit, ç'rëndësi ka, a mundet që kjo pajisje ose një pjesë e tyre të kenë një kolaudim, një rezultat duke favorizuar njërin kandidat

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

ose diskriminuar kandidatin tjetër, në mënyrë progresive apo një të dhënë paraprake, e cila vërtet që kur t'i lexon dhe korrespondon regjistrin elektronik me regjistrin mekanik, ty në pamje të parë të jepin atë përshtypjen që çdo gjë është e saktë, kur i korrespondon të dyja regjistrat, por në një moment që një ekspert IT-je i krimeve kibernetike bën këqyrjen e brendshme, ai mund ta faktojë që ajo pajisje ka qenë e paraprogramuar për të nxjerrë një rezultat të caktuar për të favorizuar apo diskriminuar njërin nga kandidatët. Unë mendoj që kjo nuk i shërben vetëm Kamzës mendoj që meqenëse është një projekt pilot duhen shteruar çdo kuriozitet, çdo hamendësim, çdo alibi, në qoftë se do të jetë alibi e ngritur, por absolutisht kjo nuk për vetë faktin duke bërë një analizë, një anormali statistikore që ka ndodhur në Kamëz, është e paprecendentë vetëm në momentin që u implementua votimi elektronik ndodhi. Pra, kjo përbën, në bindjen time, indicie të fortë për të hapur, sepse nuk ka ndodhur që një kandidat në çdo qendër votimi të humbi votat në mënyrë progresive. Edhe në Tiranë kandidati ynë ka fituar 50 vota, edhe në zona që janë extra të majta me shumicë. Një fakt tjetër, po të bëjmë analizën e atyre, se nuk do t'ju ha kohë, në 3-4 qendra, që mund t'ju a them me emra që në bastione të majta, unë afrohem, sepse aty emri im është klikuar më pak, pra dhe unë afrohem me vota me rivalin tim socialist, ndërsa në qendrat që janë bastione të djathta, unë kam humbje drastike të votave. Kjo bëhet vetëm me paraprogramim të pajisjeve. Gjithsesi, nëse ju e konsideroni të arsyeshme, unë do t'ju sjell ekspertë, të cilët absolutisht do t'ju bindin ju dhe ne që kjo pajisje është apo jo, mund të prodhojë një rezultat të paracaktuar, apo është e saktë në nxjerrjen e rezultateve, përveç veprimeve të tjera që absolutisht janë në kundërshtim të hapur. Ne kemi prova të mjaftueshme këtu që t'ju paraqesim në seancë për ato pak qendra që kemi arritur të... shiko se unë e mirëkuptoj edhe administratën që ka qenë e pamundur për një kohë relativisht të shkurtër që të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

shkarkonte në *hard disqet* e jashtme pamje të cilat absolutisht janë të pamundura për t'u shkarkuar në një kohë kaq të shkurtër. Kaq kisha, faleminderit!

**Z. E. Lako:** Po zoti Merkaj, në qoftë se keni diçka.

**Z. Y. Merkaj.** Nga çka kuptova nga shpjegimi i ankuesit domethënë që KZQ-ja ka programuar qendrat e votimit, që janë bastione të majta dhe i ka programuar 1 me 3, dhe qendrat e votimit që janë bastione të djathta i ka programuar ndryshe. Ju nuk ishte kështu, unë e kuptova kështu që bastionet e mijë...,

**Z. E. Lako:** Mirë, ato janë pretendime që ankuesi ka të drejtë t'i thotë.

**Z. I. Rusmali:** Meqë kemi eksperten, drejtoreshën këtu, a mund të na shpjegoni pak, mesa duket paska interes, procedurën e kontrollit apo *steriorin* e makinave?

**Znj. D. Alimemeti:** Në përfundim të procesit të votimit pasi printohet rezultati në letër ky informacion ruhet dhe në 2 USB –të, që janë të montuara në pajisjen e votimit elektronik. Informacioni është i ruajtur në këto 2 USB. Pra, kemi ruajtjen në 2 ambiente të ndryshme dhe në sistemin qendror derisa USB –të merren manualisht dhe kalohen nga KZAZ-ja dhe kemi në sistemin qendror të gjithë informacionin që duam, le të themi, që do të thotë se sistemi nuk bën gjë tjetër vetëm se akumulon ose mbledh ato që makinat ose pajisjet kanë nxjerrë si rezultat dhe i gjithë informacioni është i ruajtur dhe është i bërë në një *back up mirror* të menjëhershëm, ku të dyja të dhënët janë të sinkronizuara. Do të thotë informacioni në sistemin qendror është i sinkronizuar me të dhënët *back up* të pajisjeve, dhe këtë informacion mund ta gjejmë edhe te USB-të, është lehtësisht e verifikueshme. Kjo është si procedurë që ndodh në fund, le të themi, me sistemin. Në qoftë se më lejoni të sqaroj zotërinë për pjesën

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

e ndryshimit të procedurës, po jo të procedurës, po të konfigurimit të pajisjeve. Unë ju thash në fillim të herës që *software* – është i njëjtë për të gjitha bashkitë dhe në të tëra qendrat e votimit është i përdorur i njëjtë *software*. Është implementuar nga “*Smart matik*”. I gjithë procesi që nga fillimi, që nga marrja në dorëzim, të tëra pajisjet janë marrë nga “*Smart matik*”, është bërë konfigurimi.

**Z. K. Bele:** Më fal, drejtoreshë, një pyetje është këtu që mos të ikim. Kur thoni *software* është i implementuar nga “*Smart matik*”, nëse do të supozonim në një moment që do të programohesh pajisja, *software*, do të thotë që këtë punë do të duhet ose do ta bënte “*Smart matik*”, se në kuptimin tim shumë modest të botës së IT-së, ose t’i jepte një akses, kod apo çfarëdo lloji, një të treti që ta bënte. Pra, nëse flasim, supozojmë, dalim nga pozicioni që ju mbroni, supozojmë për një moment që do të ndërhyhej në këtë *software*. Kjo nuk bëhej, thënë ndryshe, pa lejen e “*Smart matik*”. Pra, në çdo rast nëse do të kishte një manipulim, *softwar-i* do të duhej

**Znj. D. Alimemeti:** Po, kjo është. do të bëhej nëpërmjet “*Smart Matik*”

**Z. I. Rusmali:** Po ta përsëris pyetjen, po në një formë tjetër. Pika 7 e nenit 22 të Kodit Zgjedhor thotë: “Pas çdo procesi zgjedhor pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe konstituimit të organeve të zgjedhura, KQZ –ja kryen në seanca publike dhe me procedurë të detajuar verifikimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informatike që janë përdorur për votimin dhe numërimin e votave në zgjedhje, nëpërmjet numërimit manual të jo më pak se 10% të qendrave të votimit dhe krahasimit të rezultatit me rezultatin e nxjerrë nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Qendrat e votimit përzgjidhen nga KQZ-ja me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore”. Pyetja ime ishte për këtë procedurë, e keni të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

detajuar këtë procedurë, e keni të planifikuar këtë procedurë? Do ta bëni këtë procedurë? Kur do ta bëni?

**Znj. D. Alimemeti:** Po. Patjetër, mbasi të shpallet rezultati.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, nga e para, e keni apo se keni, pastaj kur?

**Z. Y. Merkaj:** Më falni, këtë procedurë e kemi zbatuar edhe kur ka qenë dhe pajisjet PEI, kemi bërë këqyrjen pas zgjedhore, që e quajmë ne, po pasi mbaron, pas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. E bëjmë për zgjedhjet rastësore të njëjtën gjë, do të bëjmë edhe sivjet edhe me PEI-n edhe me PEVN-në.

**Z. I. Rusmali:** Edhe një herë, procedurën e keni të shkruar në aktet nënligjore besoj, apo jo, e keni?

*(Përgjigje pa mikrofon)*

Dakord. E keni bërë herën e parë me 10% të pajisjeve? E keni bërë me të gjithë pajisjet.

**Z. Y. Merkaj:** Herën e parë, kur ka qenë në Vorë dhe te 40-ta e kemi bërë, sepse ka...

**Z. I. Rusmali:** Ka pas pjesëmarrje të partive politike?

**Z. Y. Merkaj:** Ka qenë e hapur, po.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Ekziston opzioni që ta bëni edhe më shumë se 10% këtë herë, me gjithë Kamzën për shembull, me gjithë Elbasanin?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Ekziston mundësia, megjithatë të flas me Komisionerin.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, verifikimi i rezultatit elektronik me rezultatin e kontrollit manual jep garanci që pajisja ka funksionuar sipas rregullave, apo nuk e zbulon dot dyshimin?

**Znj. D. Alimemeti:** Verifikimi jep, le të themi, sigurinë që sistemi ka funksionuar ashtu siç duhet, verifikimi tregon, por kjo tregohej që në momentin e parë, kur partitë kanë atë *print out* –in dhe marrin rezultatin e tyre. Verifikon procesin.

**Z. I. Rusmali:** E davarit dyshimin, apo e mban në këmbë dyshimin? Të mos pyes kandidatin tani, se e di çfarë do të thotë, e davarit, apo e mban në këmbë dyshimin?

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk e mban në këmbë dyshimin.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



31

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. L. Braho:** Tani nëqoftëse pajisja është e programuar me manipulim nuk do të thotë kjo që po ky manipulim përkthehet në vota fizike? Hipotetikisht flas, sepse ai ngre pretendimin që makineria është e manipuluar jo se është ndërhyrë në system nga jashtë. Të paktën kështu si e kuptoj unë.

**Znj. D. Alimemeti:** Në common sense duhet që Smartmatic të programonte vetëm Kamzën dhe vetëm për këto pajisje le të themi të bënte implementime, ndryshime aplikacioni dhe të gjitha elementet e tjera që do ti duheshin për të qenë funksionale si pajisje. Mos të bëhej për pjesët tjeter të pajisjeve sepse nuk do të ishte...

**Z. E. Lako:** Mund të na e shpjegoni sepse jo të gjithë e dinë çfarë kompanie është, lokale, që punon në Ballkan apo është kompani që punon në botë. Nëse e dini.

**Znj. D. Alimemeti:** Kompania është ndërkombëtare. Është e mirënjohur. Funksionon në shumë vende të botës. Me informacionin unë ju dhashë dy nga vendet europiane por gjithashtu funksionon edhe në Amerikë, edhe në Kanada edhe në vende të tjera që janë një sërë dhe një mori. Është ndërkombëtare dhe beso që nuk do të shesë ose më mirë të themi nuk do të marrë, konfigurojë le të themi pajisjet për të humbur fytyrën ose imazhin e saj për një bashki në Shqipëri.

**Z. I. Rusmali:** Fole për Smartmatic pa na shpjeguar neve përsë është kaq e rëndësishme përmendja e emrit të kompanisë. Kjo do të thotë, kuтоj unë, ju më korrigjoni. Ju nuk dispononi source code e programit, e disponon vetëm Smartmatic, domethënë nëse ju personalisht dhe vartësit tuaj nuk jeni super hacker ju nuk keni çfarë ti bëni. Duhet të jeni super hacker t'ia hidhni Smartmatic dhe të bëni riprogramimin. E kam të drejtë këtë apo e kam gabim?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** Ne nuk e disponojmë source code, është e vërtetë kjo sepse shërbimi që merret nga kompania është i tillë që kompania nuk i jep source codet Shqipërisë apo çdo vendi tjetër që bën zgjedhjet le të themi. Është shërbim që ofrohet dhe nuk mund të ofrohet source code sepse ajo me këtë ushqehet.

**Z. E. Lako:** Meqenëse jemi te kodet, mund të ketë kode të ndryshme?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo.

**Z. E. Lako:** Nëse ky defekt do të ishte në Kamëz, do të dilte dhe në Elbasan edhe në Vorë, pra nuk mund të jetë i veçantë nga 2 bashkitë e tjera.

**Znj. D. Alimemeti:** Jo.

**Z. E. Lako:** Gjithashtu tek pjesa e garancive që ka parashikuar kodi dhe këto pajosjet kur të bëni ju kontrollin, verifikimin, janë të parashikuara siç e thatë dhe ju me kontrollin fizik, që nuk i jep mundësi... Këtu bien të gjitha dyshimet.

**Znj. D. Alimemeti:** Verifikon le të themi që sistemi është... ajo çfarë ka dalë nga sistemi është dhe fizikisht.

**Z. E. Lako:** Pra është 100 % reale. Po zoti Hoxha.

**Z. A. Hoxha:** Dy fjali. Meqenëse kanë funksionuar si tru të veçantë le të themi që ta thjeshtëzojmë. Secila qendër votimi sot për ju mbledh të dhënat nga të gjitha qendrat

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

në mënyrë të përgjithshme. Kjo nuk do të thotë që secila pajisje transmeton të dhënat që janë implementuar në të, që janë loguar natë e ditë. Kjo nuk do të thotë që pajisjet duhet të jenë detyrimisht me virus, me hakërim të brendshëm apo të jashtëm. Unë dyshoj se ka hackërim te brendshem, jo të jashtëm. A është bërë në të gjitha pajisjet apo jo, kjo ngelet... Atëherë përsë nuk duhet të jemi ne transparent dhe të vendosim 2-3 prej këtyre ose 10 prej këtyre pajisjeve dhe të kqyren nga ekspertët, meqenëse e kemi këtë garanci? Softueri mbledh të dhënat, nuk ndërhyr dot aty në asnjerën prej pajisjeve, jam dakord që nuk ndërhyr. Ai mbledh të gjitha të dhënat që janë loguar me secilën prej këtyre pajisjeve. Por secila prej tyre po të ketë një programin paraprak, ai do të transmetojë ato të dhëna që ne i kemi futur në nevojën e tij paraprakisht.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, por programimin paraprak mund t'ia bëj vetëm Smartmatic.

**Z. A. Hoxha:** Jo, kjo nuk është detyrimisht. Më falni që ju kundërshtoj por nuk është detyrimisht...

**Z. I. Rusmali:** Na e shpjegoni.

**Z. A. Hoxha:** Ne në kërkesën tonë kemi kérkuar të dhënat, dokumentacionin e penetrimit në pajisje dhe dokumentacionit teknik, në mënyrë që eksperti 60-70 % të punës e bën pa patur pajisjen përpara. Në moment që ai...sepse ai përcakton rrugët sesi mund të hackërohet një pajisje, jo me hackërim të jashtëm, jo me qasje në internet, por me ndërhyrje mekanike në pajisje dhe kjo rrugë nuk lë gjurmë në rrugë elektronike, kjo lë gjurmë vetëm me kqyrjen e ekspertit duke e patur pajisjen përpara dhe duke bërë... është loguar në filan orë dhe ka transmetuar x të dhënë, ka

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

përgjedhur 1-shin , apo te dyshi dhe ka përgjedhur 3-shin dhe kjo bëhet vetëm me kqyrje fizike të secilës prej pajisjeve elektronike, kjo nuk mund të bëhet me kqyrje elektronike. Unë ju thashë dhe në fillim, vërtetë nuk jam marrë me këtë, nuk jam ekspert IT, por një ekspert IT mund t'jua spjegojë më qartë . Ka patur kontestime edhe në Maqedoni, ka patur kontestime edhe në Bullgari dhe absolutisht ato janë drejt eleminimit të kësaj procedure duke bërë votim elektronik. Prandaj unë e kam kërkuar praninë e ekspertit, e kërkoj për transparencë jo vetëm pér Kamzën, por të gjithë Shqipërië nëse është një projekt dhe nuk ka përsë të hezitojë firma. Firma vendos në dispozicion dokumentacionin teknik dhe dokumentacionin e penetrimit në mënyrë që çdo të përjashtojë mundësinë e ndërhyrjes. Vetëm eksperti mund ta përjashtojë mundësinë e ndërhyrjes drejtpërdrejt në pajisjen konkrete. Sado të diskutojmë ne nuk kemi pér të arritur në një definicion përfundimtar sepse ne nuk mund të bëjmë oponencën, nuk i kemi aftësitë e duhura pér të bërë oponencën.

**Z. E. Lako:** Zoti Hoxha vetë kompania që është përgjedhur është eksperte ndëkombëtare. Vetë legislacioni yne, i konsultuar mes palëve kur ka përcaktuar këtë mënyrë votimi i ka patur parasysh të gjitha këto dhe ka parashikuar dhe mekanizmat se si do të bëhet kontrolli ku një nga mekanizmat është edhe kontrolli që na u sqarua këtu që do të bëhet nëpërmjet të dhënavë elektronike dhe atyre fizike që ndodhen në kutinë e pajisjes. Pra të gjitha këto janë të parashikuara nga ligjvënesi, Nëse ju si kandidat jeni kundër votimit elektronik apo garancive që sjell kjo është një çështje tjeter. Ndërsa pér sa i përketë ekspertizës që ju kërkon ne do e vlerësojmë si KAS. KAS këtë kërkesë, sepse ju duhet ta dini që kur ekspertiza kërkohet duhen arsyet , shkaqet, kush do i mbulojë shpenzimet, ku të çon kjo ekspertizë, ky eksperti ka njohuri më të thella sesa vet ai eksperti që është marrë me programin, çfarë ka parashikuar kodi pér këtë punë. Kështu që janë një sërë faktorësh që të çojnë në atë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

kërkesën tuaj që ne do e vlerësojmë patjetër dhe unë them që në këtë fazë nuk kemi përsë ta bëjmë debat këtë pjesë sepse ju i keni shpjeguar ato. Tani kam unë një pyetje për ju. Ju si mendoni ta vazhdojmë këtë seancë, do të vazhdoni me provat, do i dorëzoni që edhe ne ti shohim apo ju do të kërkonit kohë që të siguroni provat e nevojshme për të gjitha pretendimet tuaja dhe më pas në ta vlerësojmë këtë kërkesën tuaj.

**Z. F. Nuri:** Unë kisha dhe 2-3 pyetje të tjera krahas atyre të kandidatit për ta mbyllur dhe do ju paraqesim dhe një pjesë të provave që ne kemi. Përhembull provat me fotografi ku shohim votim familjar të theksuar dhe shpeshherë kemi operatorin i cili prek ekranin. Rreth 60 raste vetëm në një qendër votimi, në qendrën e votimit nr. 5577\1. Kjo është vetëm një por kemi dhe të tjera. Nga kqyrja e 15 kamerave vihet re kjo. I keni me foto po ti shihni me kujdes të gjitha.

**Z. E. Lako:** Zoti Nuri meqenëse unë i kam parë pak a shumë fotot dhe pjesën e ankimit, kisha disa pyetje, por nuk i konsumova me idenë që do të kërkojnë kohë dhe ju lutem nëse ne do ju japim kohë, do e vlerësojë KAS-i, do të donim që këto provat të vojnë më të argumentuara dhe pak më detajiste sepse nga fotot ne nuk e kuptojmë dot që ato janë familjare dhe janë bashkë dhe janë për këtë punë. Do të thotë ju si subjekt zgjedhor keni patur përfaqësuesit tuaj, psh. në qendrat e votimit apo edhe në KAZA, varet ku i keni pretendimet. Duhet që ...a ka ndonjë shenjë të konstatimit të subjektit tuaj, psh. Te libri i protokollit, mbedhjeve. KQV-a e ka evidentuar këtë fakt, sepse ne tani nuk mund të vlerësojmë çdo foto që të kuptojmë është bërë brenda qendrës së votimit apo në mjediset jashtë apo këta kanë qenë familjarë, janë për të votuar, sepse nuk besoj se dhe fotot duhet të jenë të tilla që ne të arrijmë në këtë vlerësim. Pra në provat që ju do të kërkonit mirë është që të keni

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

siç është libri i protokollit të zgjedhjeve apo ndonjë konstatim nga KQV-ja. Është identifikuar qoftë për veprimet e operatorëve sepse mund të ketë pretendim që kanë votuar operatorët, por duhet provuar kjo.

**Z. F. Nuri:** Nëse mund t'ju bëj një sqarim. Për provat e paraqitura keni nga një legjendë. Nga një shpjegim të shkurtër se çfarë ka ndodhur me nr. e qendrës së votimit. Kandidati deklaron se do e sjelli edhe me video të shkurtra dhe ndaj e kërkoi dhe monitorin.

**Z. E. Lako:** Mirë ju në këtë fazë kërkoni kohë për të përgatitur gjithë provat. Me sa kuptova juve kërkoni që edhe këto dy qendrat e votimit. Nuk jeni dakord që këto janë numëruar dhe kërkoni që këto të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**Z. F. Nuri:** Dhe verifikim për të gjithë materialet e tjera dhe për të gjithë mënyrën e procesit të votimit për këto dy qendra votimi. Pra padrejtësisht janë hequr...

**Z. E. Lako:** Pra ju thoni që këto 2 QV mos të konsiderohen të parregullta, por të sigurohen të rregullta dhe të përfshihen në rezultat. Pala e interesuar ka ndonjë koment për kërkeshat e dy subjektve ankues?

**Z. N. Sulaj:** Meqenëse kemi drejtoreshën këtu po gjej rastin ti bëj një pyetje. A printonte pajisja të dhëna me logon e saj, ora, minuta, sekonda në momentin që votuesi i QV-së votonte... meqenëse thatë që ruheshin të dhënat dhe pajisja elektronike printonte me logon e saj skanimin e fakes skanuese?

**Znj. D. Alimemeti:** Printonte vota po.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. N. Sulaj:** Printon votën me orë, me minutë me sekonda.

**Znj. D. Alimemeti:** Do të më lejoni ta verifikoj datën dhe orën.

**Z. N. Sulaj:** Akoma nuk e keni verifikuar?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo ideja është që a e keni me mnutë e sekonda siç e kërkon.

**Z. A. Hoxha:** Edhe një pyetje tjetër. Ju thatë ruheshin të dhënat, në usb besoj se ruhen të pajisjes që klikonte kurse në kamera skanimin e fakes për kandidatin apo për subjektin. Si ruheshin të dhënat, na e sqaroni.

**Znj. D. Alimemeti:** Në momentin që një qytetar shkonte dhe bënte zgjedhjen e votës, pasi zgjidhte le të themi kryetarin dhe anëtarin për Këshillin Bashkiak, printoheshin dy fletë votimi të cilat bien në kuti. Vetëm i verifikon nga dritarja dhe bien brenda në kuti dhe ky informacion mbylljet ketu. Këto të dhëna ruhen në usb që janë të mbyllura me kode sigurie le të themi në pajisje.

**Z. A. Hoxha:** Kam dhe një pyetje për sekretarin e KQZ-së. Përpara se të dilni me vednim përfundimtar për zgjedhjet për Këshillin Bashkiak në Kamëz. A janë krahasuar të dhënat për këto dy qendra përpala se të merrej vendimi dhe nëse po a ka rezultuar që të ketë pasë ndërrhyrje në këto dy qendra votimi apo rezultati është i saktë dhe thjesht mungon kodi 05 sipas procesverbalit të KZAZ-së?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Nga KQZ-ja është bërë miratimi i tabelës përbledhëse të rezultatit që këto dy qendra votimi duke qenë se janë konsideruar që në fillim si të parregullta nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtar.

**Z. E. Lako:** Pra nuk janë përfshirë në rezultat dhe përderisa janë konsideruar të parregullta ato nuk përfshihen, nuk është se janë ulur apo ngritur vota.

**Z. N. Sulaj:** A e ka detyrim KQZ-ja që të hetojë...

**Z. E. Lako:** Ju e kërkonci dhe ne mund ta hetojmë.

**Z. F. Nuri:** Dy pyetje se nuk arrita dot ti bëja më parë. Për KQZ-në pyetja e parë. Si ka mundësi që votimi elektronik që u fol që do të dilnin rezultatet mjaft shpejt, u shpallën rezultatet në orën 10:20 - 10:30 për të tre këto zona që u votua në mënyrë elektronike dhe ndërkohë në konferencën e shtypit zoti Celibashi nuk arri dot të na bindë le të themi për arsyet e vonesave dhe pse rezultati doli i paplotë ne atë moment, pra rrëth orës 10:30, 3 orë e gjysëm mbas mbylljes së kutive të votimit, kur ne të gjithë prisnim që rezultati të dilte për 30 minuta apo 20 minuta. Arsyja që mbaj mend që u tha nga zoti Celibashi në konferencë shtypi ishte vonesa dhe problemet me telefoninë mobile, diçka e tillë. Mund ta konfirmoni? Si ka mundësi që në një votim elektronik rezultati të dalë me kaq vonesë?

**Znj. D. Alimemeti:** Rezultati paraprak është marrë nga 802 kuti, pajisje të shpërndara në 401 QV. Që në fillim të procesit, është filluar të merret transmetimi i rezultateve. Në zona të caktuara nuk ka patur mbulim dhe transmetimi i të dhënave është vonuar. Këtë ne jemi përpjekur ta superojmë me të dhënat manuale, do të thotë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

informacionin që merrnim nga operatorët ta hidhним manualisht në sistem. Ky është procesi që unë ju svarova më parë dhe kjo është le të themi arsyja se pse kemi patur një rezultat i cili ka kërkuar pak më shumë kohë. Mbulimi dhe transmetimi jo i plotë i QV-ve ka bërë të kemi këtë rezultat, këtë informacion që ju thashë.

**Z. F. Nuri:** Pra u deshën 3 orë e gjysëm për të dhënë një rezultat përfundimtar për tre zona njëkohësisht ndërkohë që kishim dhe Vorën që kishte pak qendra votimi.

**Z. I. Rusmali:** Keni patur këtë procedurë teknike që ju ka penguar por nga ana tjetër kur është mbyllur procesi i votimit në QV Komisionerët kanë patur në orën 7-8 të darkës të gjithë rezultatin për QV-në. Nëse do i bashkonin në nivel partie e nxirrin më shpejt se ju po të donin apo jo? Rezultati i QV-së ka qenë në xhepin e secilit kur është mbyllur procesi i votimit.

**Znj. D. Alimemeti:** Kjo është thënë që në fillim... Që në fillim Komisioni Rregullator ka patur një kërkesë të veçantë për printimin e rezultatit nga pajisja PEVN dhe kjo është bërë nëpërmjet Komisionit Rregullator, është arritur të bëhet printimi edhe i kopjeve për anëtarët e QV-së edhe për vëzhguesit, të interesuarit.

**Z. I. Rusmali:** Sot që ne flasim ka ndonjë pretendim nga kushdo në Shqipëri që fleta që kanë marrë komisionerët është e ndryshme nga rezultati i publikuar nga ju?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo.

**Z. I. Rusmali:** Dakord!

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. F. Nuri:** Një pyetje të fundit për administratën e KQZ-së, ka lidhje me kompaninë Smartmatic. Ka dijeni kompania për ankimet që mund të jenë bërë dhe nëse po, a kanë reaguar ata? Nëse ka reagim nga ana e tyre, apo jeni në dijeni nëse do të ketë? Në lidhje me pretendimet që kemi ngritur ne apo subjekte të tjera zgjedhore për procesin e votimit elektronik.

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, kompania nuk është në dijeni të ankesave. Ne mund ti percjellim pyetjet ose problematikat dhe mund të marrim përgjigje, siç ishte rasti i (*nuk kuptohet*) të ndryshme që mund të marrim nëse ju intereson, por për ankimet nuk kemi ndonjë komunikim.

**Z. A. Hoxha:** Në lidhje me firmën që ka implementuar... A është e dhënë konfidenciale dokumentacioni teknik dhe çertifikata e sigurisë së tyre ndëkombëtare si ju pretenduat? Mendoj se ato duhet të na vihen në dispozicion sipas kërkesave që kemi bërë. Nuk mendoj se hyjnë tek të dhënat konfidenciale të kompanisë që mund të dëmtojë... përkundrazi e forcon imazhin e saj ndërkombëtar.

**Znj. D. Alimemeti:** Unë nuk e di se çfarë këruat konkretisht...edhe njëherë...

**Z. A. Hoxha:** Dokumentacioni i penetrimit do të thotë dokumentacion se si penetron, se si lobon, sesi logon, sesi shkon vota deri atje.

**Znj. D. Alimemeti:** Penetrim në sistem është një procedurë e cila bëhet për pajisjet që të tregojë mbrojtjen.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. A. Hoxha:** Arkitektura e sistemit, duke filluar me vetitë harduer, softuer dhe rrjetin e internetit, politikat, mënyrën si është dizenuar pjesa e votimit. Mbajtja e sigurisë deri në përfundimin e procesit dhe në fund numërimin. Çfarë hapash janë marrë për sigurinë? A ka patur Entkriptim të dhënavë, çfarë protokolli entkripti ka patur, si ka qenë ky lloj kontrolli. E keni aty por gjithsesi po jua lexoj. Kur janë ruajtur të dhënat, a ka patur të dhëna në disqe të tjera? Autentikimi dhe autorizimi, çfarë metodash kanë përdorur për këtë rast, për të shfrytëzuar këtë sistem, çfarë mekanizmash kanë përdorur për të siguruar integritetin e votuesit. Të na vihet në dispozicion hapja e kodit për investigim.

**Z. E. Lako:** I keni bërë me shkrim.

**Z. A. Hoxha:** Po, me shkrim.

**Z. F. Nuri:** E depozituar i nderuar në datën 25 maj dhe nuk kemi asnje përgjigje.

**Z. E. Lako:** Çfarë ka ndodhur zoti Merkaj me këtë kërkesën për këtë gjë.

**Z. Y. Merkaj:** I është drejtuar drejtoreshës. Drejtoresha ka menduar...

**Znj. D. Alimemeti:** Akses te kodi nuk mund të kenë. Sorscodi ishte një nga kërkesat tuaja. Unë ato kërkesa i kam lexuar. Arkitektura nëse më dëgjuat ishte le të themi sqarimi që kam bërë që nga fillimi. Do të thotë dy janë elementët kryesorë që janë pajisja në vetvete dhe sistemi. Këto dy elemente lidhen nëpërmjet një APN-je private, e cila rregullon, le të themi, është transmetimi i të dhënavë, Enkriptimi i të dhënavë është i siguruar në 4 leje të ndryshme ku një nga këto është AES256. Bën

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

edhe certifikimin, edhe autenticiteti i të dhënave sigurohet nëpërmjet këtyre protokolleve të certifikuara. Të gjithë këtë informacion mua më duket se e sqaruam, por nëse keni nevojë për përgjigje me shkrim...

**Z. F. Nuri:** Na e jepni me shkrim më mirë. Është më mirë për të gjithë.

**Znj. D. Alimemeti:** Patjetër!

**Z. E. Lako:** Mirë do të merrni përgjigje me shkrim, na u dha garancia nga administrata. Pala e interesuar ka ndonjë koment në lidhje me dy kërkesat e ankuesit në këtë fazë?

**Z. M. Legisi:** Po faleminderit! Për sa i përket Kopcionit Bashkë Fitojmë ne jemi kundër kërkesave për marrje provash pasi edhe nga materiali që ne kqyrëm, foto të zhvillimit të votimit pranë qendrave të identifikuara më shumë janë komente dhe pjesa më e madhe është kur operatori ndërhyr në votim, ndërokdhë që sipas vendimit nr. 17, 13.04.2023 të Komisionit rregullator për miratimin e rregullave dhe procedurave dhe procesin e votimit etj... I ka përcaktuar në pikën 8 ku thuhet që anëtari i KQZ-së...

**Z. E. Lako:** Provat nuk i kemi arritur, sepse nuk i kemi. Do të thotë që ata kërkojnë kohë për tërësinë e provave. Ju jeni kundër kohës, pavarësisht se administrata ja ka dhënë me vonesë materialet?

**Z. M. Legisi:** Jemi kundër sepse të gjitha pretendimet që jepen nga ankuesi na bën të mendojmë që ankuesi është tërësisht kundër votimit elektronik.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

**Z. E. Lako:** Mos ta paragjykojmë provën. Pra ju jeni kundër dhënies së kohës. Mirë, atëherë KAS për të dyja këto kërkesat do të térhiqet për vendim dhe besoj për 5-10 minuta do të ju njoftoj përsëri. Faleminderit!

**Rifillon Seanca**

**Ora 17:42**

**Z. E. Lako:** Mirë atëherë rifillojmë sërisht seancën për këto dy ankime për Bashkinë Kamëz. Përpara se të shpall vendimin që morëm në lidhje me dy kërkesat kam një pyetje për zotin Merkaj për këto dy qendrat që po diskutojmë që nuk janë përfshirë në tabelën e rezultatit përfundimtar. Kanë prodhuar rezultat këto, është i administruar ky rezultat? E keni. Mirë, atëherë KAS mori vendim në lidhje me këto dy kërkesat. Për pjesën e ankuesit të Koalicionit Bashkë fitojmë ju japim afat deri ditën e nesërme, morëm vendim pra me shumicë votash. I keni marrë tashmë të gjitha provat nga administrata e KQZ-së. I keni të sqaruara në ankım se çfarë pretendoni dhe thjesht do të bëni një verifikim në lidhje me atë që pretendoni dhe provat që keni marrë. Palëve të tjera në raste të tjera ne ju kemi dhënë afat për të plotësuar ankimin 24 orë me gjithë kohën që është dashur për të marrë provat nga KQZ-ja. Në momentin që ju i dispononi këto prova dhe e keni bërë atë kërkimin tuaj dhe pak a shumë i dini dhe i keni shkruajtur pretendimet është një afat mendojmë i mjaftueshëm në mënyrë që ti sillni dhe ti dorëzoni pranë KAS-it. Në lidhje me kërkesën e ankuesit tjetër meqenëse siç u konfirmua disponohet një rezultat elektronik për këto dy qendra votimi i kërkojmë zotit Sekretar të Përgjithshëm që këto materiale zgjedhore për këto 2 qendra votimi të paraqiten pranë KAS-it që ne të bëjmë vlerësimin a mundet që këto dy rezultate të përfshihen në tabelën...nëse do

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverballi i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2023*

të kemi një përputhje të rezultatit fizik me rezultatin elektronik të këtyre dy qendrave. Pra nga të parregullta të konsiderohen të rregullta.

**Z. Y. Merkaj:** Nëse e kuptova qartë...të sjellim kutitë...

**Z. E. Lako:** Të sillni kutite që ne të bëjmë krahasimin e votave fizike me ato elektronike. Nëse do të ketë një përputhje të kësaj ato mund të përfshien eventualisht pas vendimit që do të marrë KAS-i. Seancën e nesërme siç e theksova do ta bëjmë në orën 17:00 që të plotësohet afati 24 orë dhe i lutem administratës ti kthejë një përgjigje kërkesës që ka bërë koalicioni në lidhje me ato specifikimet teknike në lidhje me kompaninë edhe sistemin. Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

